

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5976  
E mërkurë, 15 janar 2020  
çmimi 0.40 €



## NEVER AGAIN

[kosovogenocide.com](http://kosovogenocide.com)

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**AWR ABRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SOT SHËNOHET



## 'DRITË MBI PLAGË' QË NGA SOT NË LIBRARI



### OPINION

#### FIZIKA DHE KIMIA SIMETRIKE, UDHËTIM DREJT UNIVERSIT F. 10-11

Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE

#### ÇFARË MUND TË BËJË KUSHTETUESJA PËR TA QARTËSUAR ÇAKTIMIN E MANDATARIT? F. 6

### EKONOMI

#### PORTI I DURRËSIT NË FUNKSION TË KOSOVËS, PËRPUNIMI I MALLRAVE RRIKET ME 110,6 PËR QIND F. 9

### KULTURË

#### PROMOVHEN DY LIBRA TË GANI SYLAJT BOTUAR PAS VDEKJES SË TIJ F. 14



Analisti politik Faton Abdullahu i ka kritikuar Lëvizjen Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për zvarritjen e negociatave për formimin e qeverisë së re. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto dy subjekte politike po përpiqen ta fitojnë në tavolinë atë që nuk kanë mundur ta sigurojnë në kutitë e votimit. Ai ka folur edhe

për ofertën e fundit të LV-së për LDK-në. Abdullahu ka vlerësuar se pas gjithë trumbetimit për reduktim të numrit të ministrive në 12 sosh, rritja e tyre është e neveritshme



FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON ABDULLAHU

## LV - LDK po përpiqen ta fitojnë në tavolinë atë që nuk e fituan në zgjedhje

### Qytetarëve u keqpërdoren numrat e telefonit nga kompani të ndryshme për qëllime marketingu



FAQE 5

## RENOVA

PUTZ

Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)



NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE

PRINCESHA  
GROUP SH.P.K.

INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)



## Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



## Kolegji BIZNESI

[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

## SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SRGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, d.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



## DINO

Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

Sot shënohet 15 janari, Dita e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë

# Sot shënohet 15 janari, Dita

Sot (e mërkurë) në Kosovë shënohet Dita e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë, me ç'rast përkujtohet edhe 21-vjetori i masakrës së Reçakut. Kuvendi i Kosovës më 16 maj të vitit që lamë pas ka miratuar rezolutën për "gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë", ku kjo rezolutë masakrën e Reçakut më 15 janar të vitit 1999 e ka shpallur Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë. Me rastin e 15 janarit - Ditë së Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, do të bëjë homazhe në Reçak

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 14 JANAR - Sot (e mërkurë) në Kosovë shënohet Dita e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë, me ç'rast përkujtohet edhe 21-vjetori i masakrës së Reçakut. Me rastin e këtij përvjetori të masakrës së Reçakut, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka njoftuar se të mërkurën do të bëjë homazhe në Reçak. Për 15 janarin - Dita e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë, Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", me seli në Gjenevë të Zvicrës, ka nxjerrë nga shtypi sprovën antologjike me poezi "Dritë mbi plagë". Kuvendi i Kosovës më 16 maj të vitit që lamë pas ka miratuar rezolutën për "gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë". Për hartimin e kësaj rezolute kishin punuar përfaqë-

suesit e të gjitha partive politike, përveç grupit të Listës Serbe dhe rrjedhimisht partitë politike kanë shprehur gatishmërinë e tyre për mbështetje njëzëri të Rezolutës. Rezoluta është miratuar me 79 vota për. Në rezolutën e Kuvendit të votuar më 16 maj 2019 thuhet se "kjo rezolutë nxirret në 20-vjetorin e luftës së Kosovës dhe një fushate shfaruese që kishte ndërmarrë Serbia në Kosovë. Gjatë luftës së Kosovës forcat e Serbisë dhe Malit të Zi, por më shumë të Serbisë, dëbuan mbi një milion shqiptarë, vranë mbi 12 mijë persona, civilë të pambrojtur nga të gjitha etnitë, por shumica shqiptarë. U vranë mbi 1 300 fëmijë, u dhunuan mbi 20 mijë vajza dhe gra dhe u bënë mbi 100 masakra", thuhet në tekstin e rezolutës. Më tej në rezolutë akuzohet shteti i Serbisë që gjatë vitit 1999 shumë civilë shqiptarë të gjallë dhe të vdekur u bartën në Serbi për t'i fshehur gjurmët. 1 600



persona akoma cilësohen të zhdukur. "Janë gjetur varreza masive në Serbi. Shteti serb vazhdon ta fshehtë të vërtetën edhe për mbi 1 600 persona të zhdukur. U shkatërruan mbi 100 mijë objekte banimi, ndërtesa shkollore, objekte fetare e kulturore, shkolla, xhami dhe kisha katolike", thuhet më tej në rezolutë, e cila masakrën e Reçakut më 15 janar të vitit 1999 e shpall Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në

Kosovë. Kuvendi i Kosovës i bëri thirrje shtetit të Serbisë që t'i sjellë para drejtësisë kriminelët që kanë bërë krime në Kosovë". "Të sigurohet ndëshkimi i atyre që kanë kryer dhe kanë nxitur krimet kundër njerëzimit në Kosovë. Mohimi i krimit të gjenocidit konsiderohet fyerje e rëndë ndaj viktimave dhe familjeve të tyre", thuhet në rezolutë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i pati dhënë mbështetje kësaj rezolute të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, duke thënë se "është mirë që, më në fund, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vendosur që në mënyrë të bashkuar të lëvizet përpara me nxjerrjen e një rezolute dhe dokumenteve të tjera pasuese, ku dënohet qartë gjenocidi i Serbisë i kryer në Kosovë dhe kërkohet drejtësi nga të gjitha instancat ndërkombëtare". Me rastin e Ditës së Gjenocidit, më 15 janar, të shpallur nga Kuvendi i Kosovës, Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", me seli në Gjenevë të Zvicrës, ka nxjerrë nga shtypi sprovën antologjike me poezi "Dritë mbi plagë". Ky libër tematizon gjenocidin

serb mbi shqiptarët. Është homazh artistik ndaj të gjitha viktimave. Në të janë përfshirë poetitë e 51 poetëve shqiptarë, kryesisht poezi të reja, të dërguara në Qendër enkas për këtë përmbledhje dhe të përzgjedhura nga një ekip vlerësues. Libri ka për qëllim zgjimin e vëmendjes dhe ndëshkimin nga ana e drejtësisë. Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" ka falënderuar poetët si dhe të gjithë ata që u angazhuan për botimin e këtij libri. "Do të ketë njoftime me kohë për datat e promovimeve të librit në Prishtinë, Tiranë e Shkup, personalisht apo nëpërmjet faqes zyrtare të Qendrës, sigurisht edhe nëpërmjet mediave", është theksuar në njoftimin e kësaj Qendre.

**William Walker: Reçaku ka ndodhur, bota mësoi për të dhe bota reagoi**

Ambasadori amerikan William Walker, i cili gjatë vitit 1999 ka shërbyer shef i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, ka shprehur kundërshtimin për

## Më 30 qershor 2019 në Bernë të Zvicrës u themelua 'Qendra Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur'

Qendra ka për qëllim të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë dhe të këmbëngulin në domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë. Në takimin e 30 qershorit u miratua logoja e qendrës, ku katër petalet e lulëkuqes paraqesin katër format e veprimeve të gjenocidit që u zbatuan në

Kosovë: vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimi etnik dhe shkatërimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar. Ndërsa në vend të kokrave të zeza të lulëkuqes, në logo janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash për t'i përfshirë të gjitha kategoritë e shqiptarëve që ishin shndërruar në objekt shkatërimi nga politika e gjenocidit të Serbisë. Nismëtarët e themelimit të kësaj qendre vendosën t'ia besojnë

udhëheqjen e saj politologut Bardhyl Mahmuti. Ftojme të gjithë ata të cilët janë të interesuar që vullnetarisht të ndihmojnë për ndriçimin e gjenocidit në Kosovë, kudo qofshin në botë, t'i bashkëngjiten qendrës "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" dhe ta japin kontributin e tyre për ta bërë të njohur në çdo cep të globit tragjedinë që ka përjetuar populli shqiptar i Kosovës. **Bernë, më 30 qershor 2019**

# e Gjenocidit Serb në Kosovë



të gjithë ata që nuk e pranojnë ngjarjen e Reçakut, më 15 janar 1999, si masakër. Walker po qëndron në Kosovë me rastin e 21-



vjetorit të masakrës së Reçakut, ku forcat serbe kanë vrarë 45 civilë shqiptarë. Ai ka polemizuar nga distanca me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka thënë se masakra e Reçakut nuk ishte e vërtetë. Walkeri ka thënë se kur i dëgjon deklaratat e Vuçiqit ato ia rikujtojnë ato të Slllobodan Millosheviqit, i cili, sipas tij, fliste njësoj për Reçakun. "Unë nuk jam këtu sot të vërtetë se Reçaku nuk ishte gjenjeshër. Bota e ka kuptuar se Reçaku ka ndodhur. Aty dyzet e më shumë fshatarë të një fshati të pambrojtur ishin masakruar. Aty është

kryer një krim lufte dhe është kryer nga forcat e sigurisë së Beogradit, nën komandën e Slllobodan Millosheviqit. Njerëzit më pyesnin mua rreth reagimit tim ndaj presidentit serb Vuçiq, i cili më ka quajtur gjenjeshër, duke thënë se Reçaku nuk ka ndodhur. Reagimi im ishte se po i dëgjoj fjalët e Slllobodan Millosheviqit edhe një herë. Reçaku ka ndodhur, bota mësoi për të, bota reagoi", ka thënë Walkeri në konferencën e organizuar nga Republikanët e Kosovës (REK) të quajtur "Reçaku nuk është gjenjeshër".

## DEKLARATË

Gjatë luftës së viteve 1998-1999 Kosova u shndërrua në "Teatër me dyer të mbyllura", ku shteti serb vuri në skenë tragjedinë shqiptare, ndau rolet e aktorëve, dirigjoi çdo veprim në operacionet luftarake të ndërmarra me qëllim shkatërrimin e tërësishëm ose të pjesshëm të shqiptarëve dhe në fund rrënoi skenografinë ku u krye gjenocidi. Megjithatë, krimet e tmerrshme të gjenocidit dhe tragjedia e shqiptarëve të Kosovës nuk mundi të mbahej e fshehur. Ndërhyrja e shteteve demokratike perëndimore i dha fund barbarisë serbe dhe mundësoi të dilnin në shesh vrasjet e mbi dhjetë mijë shqiptarëve, dhunimet seksuale të mbi njëzet mijë femrave shqiptare, spastrimi etnik i Kosovës me dëbimin e shumicës dërrmuese të shqiptarëve dhe asgjësimin e dokumenteve të identifikimit, shkatërrimi i 100 589 shtëpive, i 88 101 objekteve përcjellëse, i 358 shkollave, i 30 shtëpive kulturore, i monumenteve historike, i 93 bibliotekave, i 123 institucioneve shëndetësore dhe i 220 objekteve të kultit fetar (xhami, teqe, tyrbe dhe kisha katolike)... 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë nuk dihet asgjë për fatin e mbi 1 600 personave,

gjurmët e të cilëve u zhdukën nga forcat serbe. Gjenocidi në Kosovë është një plagë e hapur që kërkon trajtim të drejtë! Mohimi i gjenocidit paraqet fyerje të rëndë ndaj viktimave, ndaj familjarëve të tyre dhe kombit ndaj të cilit është kryer gjenocidi. Ballkani Perëndimor ka nevojë për paqe, por ardhmëria paqësore nuk mund të ndërtohet mbi gënjeshtër dhe mohim të krimeve. Mohimi i gjenocidit minon ndërtimin e paqes së qëndrueshme! Njohja, pranimi dhe dënimi i gjenocidit në Kosovë ndihmon në shërimin e plagëve të hapura dhe mundësojnë që një ditë të bëhen realitet premtimet e shpeshta për "KURRË MË GJENOCID"! "Qendra GJENOCIDI NË KOSOVË - PLAGË E HAPUR" synon të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë dhe këmbëngulin në domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë. Jemi të bindur se ndriçimi i plotë i kësaj tragjedie njerëzore kontribuon në parandalimin e gjenocideve të reja kudo qoftë në botë.

## 'DRITË MBI PLAGË' QË NGA SOT NË LIBRARI

Që nga sot në librarinë "Artini" dhe "Dukagjini" dhe te shitësit e librave në sheshin "Zahir Pajaziti" dhe "Nënë Tereza" do ta gjeni edhe librin "Dritë mbi plagë" të cilin e ka botuar dhe përgatitur Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", hartuesit Lulëzim Etemaj dhe Isuf Sherifi, së bashku me kryeredak-

torin Muhamet Mavraj dhe anëtarët e redaksisë: Myrvete Dreshaj-Baliu, Hajdin Morina, Salajdin Salihu, Shqipe Bytyqi. Në këtë libër janë bërë bashkë 51 poetë, me nga një, dy, tri dhe katër poezi, për të rrëfyer për përjetimin e gjenocidit në Kosovë qoftë nga vetë poetët, qoftë nga familjarët e tyre, nga

fqinjët e tyre dhe nga populli shqiptar. Kërkesa e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" është që ky libër të lexohet dhe të shpërndahet ndër duar të shokëve dhe miqve tuaj dhe bashkërisht t'i përkujtoni ditët e gjenocidit në Kosovë dhe mos t'i harroni kurrë. NEVER AGAIN



## Këshilli Prokurorial prezanton planin e punës për vitin 2020

PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Fuqizimi i kornizës ligjore dhe integritetit, transparenca dhe llogaridhënia sistematike, avancimi i sistemit për vlerësimin e performancës së prokurorëve, ishin disa prej shtyllave kryesore që përmban plani i punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin 2020, i miratuar sot në takimim e 176 të vet. Gjithashtu, Këshilli, i udhëhequr nga kryesuesi i tij, Bahri Hyseni, ka miratuar Rregulloren për trajnime dhe zhvillimin profesional në

sistemin prokurorial, e cila përcakton standardet dhe udhëzimet e trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër, si dhe mbikëqyrjen e zhvillimit profesional të prokurorëve dhe personelit administrativ në sistemin prokurorial. Gjatë takimit janë miratuar rekomandimet e raportit të Komisionit për transferimin dhe avancimin e tre prokurorëve të shtetit, me ç'rast avancohet një prokurorë në Prokurorinë



Themelore të Pejës nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda, e cila njëkohësisht do të transferohet për një periudhë

njëvjeçare në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, kurse një prokurorë e Prokurorisë Themelore në Prizren është avancuar nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur. Në këtë kontekst, pas shpalljes së brendshme për avancimin e një pozite në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës është konstatuar se nuk janë plotësuar kriteret e

kërkuara dhe është vendosur të bëhet rishpallja e brendshme. Nga ana tjetër, në kuadër të përmirësimit të njohurive dhe aftësive të mentorimit për t'u marrë me rastet e synuara të Prokurorit të Shtetit, KPK-ja ka dhënë pëlqimin që grupi i përzgjedhur i prokurorëve për ta ndjekur programin e mentorimit në katër module gjatë muajve mars, qershor, shtator dhe nëntor të vitit 2020 në Londër, ndërsa shpenzimet do të mbulohen nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON ABDULLAHU

# LV - LDK PO PËRPIQEN TA FITOJNË NË TAVOLINË ATË QË NUK E FITUAN NË ZGJEDHJE

Analisti politik Faton Abdullahu i ka kritikuar Lëvizjen Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për zvarritjen e negociatave për formimin e qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto dy subjekte politike po përpriqen ta fitojnë në tavolinë atë që nuk kanë mundur ta sigurojnë në kutitë e votimit. Ai ka folur edhe për ofertën e fundit të LV-së për LDK-në. Abdullahu ka vlerësuar se pas gjithë trumbetimit për reduktim të numrit të ministrive në 12 sosh, rritja e tyre është e neveritshme



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 JANAR -

"Epoka e re": Z. Abdullahu, bisedimet në mes të LV-së dhe LDK-së sërish kanë ngecur. LV-ja thotë se fajin e ka LDK-ja sepse po kërkon kryeparlamentarin, kurse LV-ja fajëson LV-në. Çfarë po ndodhë?

**Abdullahu:** LV-ja dhe LDK-ja po përpriqen ta fitojnë në tavolinë atë që nuk kanë mundur ta sigurojnë në kutitë e votimit. Djallëzia e suksesshme politike për ta lexuar dhe prezantuar votën, përkatësisht vullnetin e qytetarit, ashtu sikundër nuk ishte në të vërtetë, atyre ua ka legjitimuar grykësinë për më shumë pushtet. Për më keq që të dy këto forca, sidomos gjatë fushatës, kanë mashtruar qytetarin e Kosovës. E para, LV-ja, me puritanizëm populist, por pa kokrrën e përvojës institucionale, duke servuar me truke prej magjistari, atë që dëshiron qytetari ta ketë e ta dëgjojë e duke anashkaluar në thelb atë që mund ta marrë ai dhe Kosova realisht. E dyta, LDK-ja, me një mashtrim optik politik, duke e shfrytëzuar opozitarizmin e brendshëm arrogant si metodikë, por impotent si cilësi, të cilës i printe Vjosa Osmani, e cila ishte një 'mini vetëvendosje' brenda LDK-së, u paraqit rrejshëm si shpresë për ndryshime, me çka i shkoj për dore ta mashtrojë edhe qytetarin edhe LV-në. Tani duhet ta mashtrojnë njëra-tjetrën, por kjo nuk po u shkon për dore. Mashtruesi nuk mund ta mashtrojë mashtruesin. Për këto njëqind ditë që të dyja e kanë perfeksionuar edhe fjalorin dhe metodikën e fajësimit si premisë për ta shfaqësuar veten për mosbërjen e qeverisë. Në

këtë përbaltje që të dyja po kanë sukses te militantët e tyre, por jo edhe te shtresat e gjëra të qytetarëve. Zhgënjimi çdo ditë po rritet, edhe humbjet për Kosovën po shtohen.

"Epoka e re": LV-ja ka bërë me dije se tani ia ka bërë edhe një ofertë LDK-së, duke i shtuar ministrinë nga 12 në 14 sosh. A mendoni se kjo është zgjidhja?

**Abdullahu:** Rritja apo zvogëlimi i numrit të ministrive në veten e saj nuk mund të jetë premisa e performancës më të mirë apo më të keqe për një qeveri. Pas gjithë trumbetimit me rrahagjoks, se numri i ministrive po reduktohet në 12, rritja e numrit të ministrive tani është e neveritshme. Për më shumë, sipas këtij justifikimi të munguar sot, ai numër mund të rritet edhe nesër. Oferta e re e LV-së për më shumë ministri do të thotë përpjekje për ta shuar grykësinë individuale dhe klanore të qarqeve të caktuara të këtyre dy forcave e cila bëhet edhe përkundër faktit se kjo ia shton një ministri Listës Serbe për të cilën në fillim pretendohet me axhamillëk se nuk do të bashkëpunohej dhe thuhej se nuk do të jetë pjesë e qeverisë. LV duke e bërë këtë ofertë të re edhe për Listën Serbe, dhe duke e pranuar që të vendoset për Presidentin që tani, i cili, sipas kësaj marrëveshje, do të jetë ekskluzivisht partiak, e humb virgjërinë e pretenduar politike ende pa u krijuar qeveria. Mendësia e re politike, apo sikundër po thuhet, instalimi i një praktike të re jo vetëm politike, vdes që këtu. Mund të konstatohet kështu sepse kjo ofertë e re na jep të kuptojmë se të tilla alleshverëshe do të vazhdojnë edhe në një qeveri të mundshme nga këto dy forca politike.

"Epoka e re": A besoni se problemi mes këtyre dy subjekteve politike është vërtet te postet apo ka diçka tjetër që po e pamundëson këtë koalicion?

**Abdullahu:** Sa më shumë po zgjatë koha përbrenda së cilës këto dy subjekte nuk po merren vesh për karrige dhe sa më shumë ato bashkë me ofertën e re po servojnë akuza e dyshime të vjetra, aq më shumë po rritet dyshimi se mospajtimi i LV-së me LDK-në ka një hile edhe diku tjetër. Mungesa e respektit të ndërsjellë ndërmjet këtyre partive, paragjykimet deri në paranojë politike, si dhe mosbesimi që determinohet edhe nga tradita kriminale dhe akuzat

banale që i kanë pasur në raporte e tyre, ka ngjallur fort dyshimet se edhe nëse ky koalicion formohet nuk do të jetë as jetëgjatë e as i dobishëm. LV-ja dhe LDK-ja e matin dhe e vlerësojnë njëra-tjetrën edhe në raport me dialogun me Serbinë. Që të dyja e dinë se kjo çështje i pret me të hapur derën e qeverisë që mund të krijohet. LDK-në nuk e merr gjumi natën kur e di se çfarë qasje ka LV-ja ndaj dialogut me Serbinë. Ajo e di se LV-ja ka këtë qëndrim zyrtar - çështjen e dialogut nuk e ka as prioritet, as nuk e merr me nxitim, për më shumë së pari do t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani. Qëndrim

kryekëput në kundërshtim me qëndrimet dhe aspiratat e ShBA-së në rajon. LV-ja në anën tjetër është pothuajse e bindur se LDK-ja do ta lë në baltë në çdo rrethanë LV-në kur është fjala për dialogun me Serbinë dhe për këtë znj. Osmani nuk do të jetë në gjendje as t'i shprehë keqardhje.

"Epoka e re": Në bazë të asaj që keni parë deri më tani, është i mundshëm koalicioni LV-LDK?

**Abdullahu:** Unë besoj se koalicioni LV - LDK është i mundshëm të krijohet, por jam i bindur se është i pamundshëm të krijojë të mira për këtë vend, të qëndrojë gjatë dhe të japë

rezultate për një jetë më të mirë për qytetarët. Ky nuk është paragjykim i im. Ky është gjykim në avancë, i bazuar në paragjykimet që këto dy forca kanë ndaj njëra-tjetres, me çka edhe kanë ngjallur dyshimin e bazuar edhe te qytetarët dhe te partnerët tanë. Unë nuk shoh as guxim, as moral të mjaftueshëm as te LV-ja dhe as te LDK-ja, që për parime politike ato të heqin dorë nga privilegjet pushtetare. Thjesht, këto dy gjysma nuk mund ta bëjnë një qeveri të plotë funksionale. E para, LV-ja është e guximshme jashtë institucioneve, por aventuriere për dhe në institucione. E dyta, LDK-ja është institucionaliste, por jo institucionalisht e guximshme. E keqja më e madhe do të jetë se LV-ja dhe LDK-ja nuk do të mund të sigurojnë unitet të mjaftueshëm për t'u përballur me Serbinë, për rrjedhojë as të kemi mendësi politike serioze, kooperuese dhe institucionalisht të guximshme.

**"Epoka e re":** Çka nëse nuk arrijnë të bëjnë marrëveshje këto dy parti. Cila është zgjidhja?

**Abdullahu:** Nuk është zgjidhje e mirë që të shkohet në zgjedhje sepse do të humbim kohë dhe para. Do të ngecin shumë procese dhe do t'i humbim 5-6 milionë euro për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Mirëpo tani pas tre muajve, konsideroj se baza mbi të cilën qytetari ka krijuar bindjen politike për ta shprehur vullnetin me votën e tij në zgjedhjet e fundit ka filluar të ndryshojë shpejt dhe shumë. Nëse vazhdon kështu dhe 2-3 javë, me këtë marrëzi politike pa marrëveshje, me akuza të ndërsjella e me moskokëçarje për fatin e vendit tonë, zgjedhjet e ardhshme do të jepnin rezultate krejt të ndryshme nga ato që i patëm herën e fundit. Përndryshe konsideroj se për shkak se pajustificueshëm nuk ka marrëveshje ende, për shkak se përbrenda kësaj periudhe demet po rrjedhin pandalshëm në shumë sfera të determinuara nga mungesa e qeverisë së re, Presidenti, Gjykata Kushtetuese, deputetët e rinj të Kuvendit të Kosovës, Avokati i Popullit, apo të gjithë së bashku, duhet të përfshihen në ndonjë mënyrë për ta mbushur disi me logjikë politike 'zbrazëtine juridike' me qëllim që të zhblllokohet situata e krijuar. Ky zhblllokim nuk do të thotë detyrimisht të insistohet të krijohet qeveria LV - LDK, por të shihen edhe mundësitë e kombinimeve të reja ndërmjet subjekteve të interesuara për ta bërë qeverinë, apo edhe të shkohet në zgjedhje të reja. Kalimi i kohës përbrenda së cilës nuk kemi qeveri të re, jo që e bën të justifikueshëm trysinë e këtyre subjekteve që i përmenda për të kërkuar rrugëdalje, por i bënë ato të papërgjegjshme nuse nuk e bëjnë këtë.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) pritet ta shqyrtojë ofertën e re të Lëvizjes Vetëvendosje e cila përfshinë shtimin e numrit të ministrive

# VETËVENDOSJA I BËN OFERTËN E FUNDIT LDK-SË, I JEP NJË MINISTRI MË SHUMË

Lëvizja Vetëvendosje i ka bërë një ofertë të fundit Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për bashkëqeverisje, e cila përfshin rritjen e numrit të ministrive. Pretendenti kryesor për kryeministër, Albin Kurti, i ka propozuar LDK-së që numri i ministrive të rritet në 14 sosh nga 12 sa ishin pajtuar, me ç'rast Lëvizja Vetëvendosje do t'i ketë pesë ministri, kurse LDK-ja gjashtë ministri. Sipas ofertës së LV-së, ministria shtesë për LDK-në vjen si pjesë e njëres prej ministrive më të mëdha që ka LV-ja. Ndërkaq tri ministri do t'i kenë pakicat, siç edhe parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 14 JANAR** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti, të hënën në mbrëmje i ka bërë edhe një ofertë të re Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e koalicionit qeverisës. Në ofertën e fundit, Kurti ka paraparë 14 ministri.

Sipas kësaj oferte, Lëvizja Vetëvendosje do t'i ketë pesë ministri, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës gjashtë ministri. Ministria shtesë për LDK-në vjen si pjesë e njëres prej ministrive më të mëdha që ka LV-ja. "I nderuar kryetar i LDK-së, z. Isa Mustafa. Në kuadër të bisedimeve tona për formimin e koalicionit qeverisës, në takimin tonë të fundit të mbajtur të enjten, më 9 janar 2020, kam bërë propozimin përfundimtar për marrëveshje ndërmjet dy subjekteve tona. Sipas kërkesës suaj në komunikimin tonë të fundit, po jua dërgoj atë edhe me shkrim: E shtojmë numrin e ministrive në qeveri, nga 12 në 14 sosh, me ç'rast Lëvizja Vetëvendosje i ka 5 ministri, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës i ka 6 ministri. Ministria shtesë për LDK-në vjen si pjesë e njëres prej ministrive më të mëdha që ka LV-ja. 3 ministri i kanë pakicat, siç edhe parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Vlen dakordimi i mëhershëm që zëvendëskryeministri i parë i takon LDK-së, ndërkaq zëvendëskryeministri i dytë LV-së", është thënë në ofertën e Kurtit.

Më tej, sipas kësaj oferte, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ndahet, ashtu që Kultura dhe Rinia i bashkëngjiten Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa Sporti i bashkëngjitet Ministrisë së Shëndetësisë. "Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal janë dy nga tri ministroritë që u jepen pakicave. Ministria e tretë është ajo për Komunitete. Bëhet një formulim i përbashkët



për çështjen e Presidentit të Republikës së Kosovës bazuar në draftin fillestar nga LDK-ja që përfshin qëndrimin karshi presidentit aktual, përpjekjen për konsensus dhe kufizimin karshi ujdive eventuale me ish-PAN-in. Shpresoj ta pranoni propozimin tonë dhe pa humbur kohë ta formojmë qeverinë e ta zbatojmë programin e harmonizuar qeverisës", ka thënë Kurti në ofertën e tij drejtuar Mustafës.

Fillimisht është thënë se për ofertën e fundit të LV-së do të vendosë Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së, por më pas është raportuar në media se organi më i lartë i LDK-së ka autorizuar kryetarin dhe tre nënkryetarët që të marrin vendim.

Nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë për 'Telegrafin' se në këtë ofertë nuk ka diçka të re dhe serioze që do të mund ta zgjidhte situatën drejt një marrëveshje përfundimtare. Megjithatë, sipas tij, kjo ofertë duhet të shqyrtohet brenda organeve të LDK-së.

Edhe njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se këto dy parti duhet të pajtohen për një qeveri më të gjerë.

Analisti politik Naim Rashiti ka thënë se Vetëvendosja dhe LDK-ja duhet të pajtohen për një qeveri me 15 ose 16 ministri. "LV-ja dhe LDK-ja duhet të heqin dorë nga strukturimi dhe fuzionimi masiv i qeverisë dhe ministrive. Kjo lehtëson arritjen e marrëveshjes dhe parandalon kaosin në institucione. Ju siguroj se nuk do të arrijnë ta bëjnë ristrukturimin në 12 ministri dhe pa ligj. Prandaj, LV-ja dhe LDK-ja nëse duan të formojnë qeveri duhet ta dorëzojnë emrin e mandatarit shpejt dhe të pajtohen për një qeveri me 15-16 ministri: LV-ja të marrë 6 ministri; LDK-ja të marrë 7 ministri; serbët 2 ministri (përndryshe nuk e përkrahin qeverinë); minoritetet e tjera një ministri", ka shkruar Rashiti në profilin e vet në "Facebook". Gjithashtu, ai ka vlerësuar se LV-ja duhet sa më shpejt ta dërgojë

emrin e kandidatit për kryeministër në Presidencë. "Lëvizja Vetëvendosje urgjentisht duhet ta dorëzojë emrin e kandidatit për kryeministër. Si fituese e zgjedhjeve nuk ka alternativë, nuk ka afat të caktuar mes konstituimit të Kuvendit dhe dhënies së mandatit për fituesin e zgjedhjeve. Kjo është procedurë e pakontestuar. Me vonesat e saj, LV-ja po bëhet njëjtë sikur partitë fituese të vitit 2014 dhe 2017", ka vlerësuar Rashiti.

Edhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kërkuar të martën nga LV-ja formimin sa më të shpejtë të Qeverisë së re. Në takimin e fundit që krerët e këtyre dy subjekteve politike kishin mbajtur javën e kaluar, LDK-ja kishte kërkuar që t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit për të bërë marrëveshje me LV-në. Kjo e fundit e kishte refuzuar një gjë të tillë dhe si kompromis i kishte propozuar LDK-së që ta marrë Ministrinë e Punës së Jashtme.

# Çfarë mund të bëjë Kushtetuesja për ta qartësuar caktimin e mandatarit?

"Përgjegjësia kushtetuese e presidentit është funksionalizimi i institucioneve. Ai është garantues i funksionimit kushtetues e demokratik dhe është i obliguar të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta përmbushur këtë detyrim të tij, duke mos përjashtuar edhe kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të sqaruar çdo paqartësi kushtetuese dhe ligjore në shërbim të funksionalizimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja", thuhet në përgjigjen e Zyrës së Presidentit të Kosovës.

PRISHTINË, 14 JANAR - Zyra e Presidentit të Kosovës ka paralajmëruar mundësinë që presidenti Hashim Thaçi t'i drejtohet me një kërkesë Gjykatës Kushtetuese për t'i sqaruar paqartësitë kushtetuese dhe ligjore në rast se do të ketë vonesa të mëtejme për formimin e koalicionit qeverisës ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, koalicioni i cili do ta formonte qeverinë e re. Këtë e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", Zyra e Informimit e Presidencës së Kosovës. "Përgjegjësia kushtetuese e presidentit është funksionalizimi i

institucioneve. Ai është garantues i funksionimit kushtetues e demokratik dhe është i obliguar të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta përmbushur këtë detyrim të tij, duke mos përjashtuar edhe kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të sqaruar çdo paqartësi kushtetuese dhe ligjore në shërbim të funksionalizimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja", thuhet në përgjigjen e Zyrës së Presidentit të Kosovës. Megjithatë, kjo zyrë nuk ka sqaruar se kur presidenti i vendit do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë

çështje. Florent Spahija, ekspert ligjor në Institutin Demokratik të Kosovës, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se kërkesa eventuale e presidentit të Kosovës për të kërkuar sqarim nga Gjykata Kushtetuese lidhur me sqarimin e, siç është thënë, "çdo paqartësi kushtetuese dhe ligjore në shërbim të funksionalizimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja", do të ishte e kotë për shkak se Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur një herë për një çështje të caktuar dhe ka thënë se institucionet e Kosovës nuk kanë të drejtë të dërgojnë më pyetje për sqarim të çështjes së njëjtë te kjo gjykatë. "Është e kotë drejtimi në Gjykatën Kushtetuese, meqë nuk kemi rast. Pra, nëse presidenti do të donte t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese duhet të kishte rast. Por, në këtë situatë nuk ka rast dhe nuk ka çfarë të sfidojë te Gjykata Kushtetuese. Nuk kemi ende një rast kushtetues që të shkohet më tutje. Sikur të refuzohej emri i kandidatit ose subjekti politik (Lëvizja Vetëvendosje) të

deklaronte se nuk do ta dërgojë emrin e kandidatit, atëherë do të mund të ishte një rast. Por, për momentin nuk ka rast", ka thënë Spahija.

Kur Spahija thotë se Gjykata Kushtetuese ka dhënë mendimin e saj për një çështje të ngjashme ai i referohet sqarimit që kjo gjykatë ka dhënë pas kërkesës që ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ia kishte drejtuar këtij institucioni më të lartë të drejtësisë në qershor të vitit 2014. Jahjaga kishte kërkuar sqarimin e çështjeve kushtetuese që ndërldheshin me përgjegjësitë e saj, për përcaktimin e mandatarit për themelimin e qeverisë, në përputhje me nenin 84, pika 14, si dhe nenin 95 të Kushtetutës së vendit.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje u soll dhe u publikua më 1 korrik 2014. "Nëse kandidati i propozuar për kryeministër nuk merr votat e nevojshme, presidenti i Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për kryemi-

nistër, pas konsultimit me partitë ose me koalicionet (e regjistruara në pajtim me Ligjin për zgjedhje e përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun", thuhej në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, Kushtetuta nuk përcakton ndonjë afat kohor për propozimin e mandatarit për formimin e qeverisë së re nga partia fituese e zgjedhjeve, në rastin e tanishëm, nga Lëvizja Vetëvendosje.

Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, që nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë duke bërë përpjekje për arritjen e një koalicioni qeverisës, të cilat deri më tash kanë rezultuar të pasuksesshme. Më 10 janar, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka shkruar letër kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, duke i kërkuar atij emrin e mandatarit të Vetëvendosjes për postin e kryeministrit, për t'i evituar vonesat rreth formimit të qeverisë së re.

Thaçi kishte shkruar se do "të ndërmarrë veprime pa vonesa të mëtejme, duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë sa më shpejt qeverinë e tyre".

Më 13 janar kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një përgjigje me shkrim i është drejtuar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, duke i kërkuar që të mos bëhet presion për emrin e mandatarit për kryeministër të ardhshëm të Kosovës. Ai ka thënë se "Kushtetuta e Kosovës nuk i njeh presidentit diskrecion e as rol aktiv në procesin e caktimit të mandatarit apo edhe të garantimit të një shumice parlamentare për zgjedhjen e qeverisë në Kuvend".



## 'Bereqeti' vazhdon t'u dalë në ndihmë familjeve në nevojë

PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Në vazhdim të aktiviteteve, shoqata humanitare bamirëse "Bereqeti", e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, ka shpërndarë 800 kilogramë miell kryesisht për pleqtë e vetmuar, të cilët, në marrëveshje me furra të ndryshme, marrin bukë të gat-

shme. Drejtori i shoqatës humanitare bamirëse "Bereqeti", Behxhet Ajvazi, ka thënë se 800 kilogramë miell i ka dhuruar donatori Shefki Pacolli nga Hajvalia e Prishtinës dhe do të ndahen kryesisht për familjet në nevojë e që janë në regjistrin e shoqatës "Bereqeti". "Ne si shoqatë jemi munduar t'u

dalim sadopak në ndihmë qytetarëve të cilët kanë nevojë në këto ditë dimri. Ua kemi dhënë dhjetë familjeve nevojtare në Prishtinë nga dy metra dru për ngrohje. Kryesisht janë përzgjedhur familjet që kanë jetimë. Me këtë rast falënderojmë Blerim Vitinë dhe Xhevdet Haxhollin nga Hajvalia për këto ndihma", ka thënë Ajvazi.



# Kërkohet përcaktimi i prioriteteve për mbrojtje nga tërmetet

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 JANAR - Tërmetet e njëpasnjëshme të 26 nëntorit 2019 në Shqipëri lanë të vdekur e të lënduar qindra qytetarë si dhe rrënuan dhe dëmtuan qindra ndërtime banesore dhe afariste. Si pasojë e kësaj tragjedie, për të diskutuar për përballojë një tërmet me intensitet të ngjashëm me tërmetin e datës 26 nëntor 2019 në Durrës".

Kjo konferencë mbledhi bashkë zyrtarë dhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Shëndetësisë, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, si dhe ekspertë dhe profesorë vendorë dhe nga rajoni të kësaj fushe.

Punimet e konferencës i hapi rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili tha se institucioni që ai drejton rikonfirmoi mbështetjen për shtetin e Shqipërisë. "Kjo konferencë duhet të shërbejë si reflektim në aspektin akademik dhe profesional, pra tashmë në këtë drejtim duhet të përfshihen edhe teknologjitë e reja sepse janë të nevojshme në këtë proces, por sigurisht konsideroj se duhet të krijohen procese dhe studime të mirëfillta, njëherësh mendoj se debate të tilla më shumë se kurrë janë të nevojshme. Marrja e rekomandimeve dhe konkluzioneve nga profesorë të

UBT-së dhe inxhinierët e pranishëm ndihmon në zvogëlimin e efekteve dhe pasojave në raste të tilla të tragjedive", ka vlerësuar rektori Hajrizi.

Duke falënderuar profesorët e UBT-së dhe inxhinierët e Ministrisë së Infrastrukturës në Kosovë për ndihmën dhënë në aspektin akademik e profesional, ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka thënë se pas kësaj ngjarje duhet të vepohet nga organet kompetente për ta përmirësuar cilësinë e ndërtimeve. "Tërmeti nuk parashikohet dhe nuk mund të parandalohet, por efektet janë të parandalueshme. Ky debat u organizua dhe bëri bashkë inxhinierë, profesorë dhe studentë për të dhënë konkluzione. Ka ardhur koha që tashmë të veprojmë si komb. Bashkërisht do të duhej të punojmë në koncepte dhe të bashkëveprojmë për t'i zvogëluar dëmet siç i patëm në tërmetin e fundit në Shqipëri. Duhet të bashkohemi për të hartuar projekte të përbashkëta në nivel kombi", është shprehur ambasadori Minxhozi.

Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, ka thënë se ekzistojnë ligjet përkatëse si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri që do të duhej të zbatoheshin në përpikëri nga ndërtuesit e ndërtimeve të ndryshme. "Tërmeti në Shqipëri ka qenë ngjarje e dhimbshme dhe na ka tronditur që të gjithëve. Shkaktoi kaos të madh, por çka pas këtij tërmeti. Në kuadër të mobilizimit të ministrisë ku veprojmë, së bashku me UBT-në ne dërguam atje ekspertë tanë për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve, por vërtet ka qenë tragjedi e madhe me pasojë të rënda. Këto pasojë ndihen edhe në Kosovë, por



ligjet janë aq të përpikta sa që shumë pak gjetën zbatim në praktikë nga ndërtuesit", ka deklaruar Kadriu.

Inxhinierja nga Shqipëria, prof. dr. Luljeta Bozo, ka theksuar rëndësinë e sigurisë së objekteve në Kosovë, me theks të veçantë në Shqipëri, ku tha se ka mungesë të kuadrit ligjor e institucional për kontrollimin dhe mbarëvajtjen e ndërtimeve. Sipas saj, objektet e rrënuara në Shqipëri nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 kanë pasur probleme dhe kanë qenë të ndërtuara në zona ku nuk duhej të ndërtohej, si zona e kënetës dhe e plazhit. "Tërmeti i fundit në Shqipëri ishte i cekët dhe afër qendrave të banuara me njerëz në Tiranë dhe në Durrës, por nuk ishte i një intensiteti aq të lartë sa të shkaktojë aq viktima. Problemi është se kjo ndodhi për shkak të shkeljeve të rënda në procesin e ndërtimit, sepse një objekt i

projektuar drejt rrallë pëson gjë. Shqipëria ndodhet në zonën që quhet Brezi i Zjarrtë, që është gjithë zona e Mesdheut, dhe është kufiri ndarës i dy pllakave, Euroazisë me Afrikën, dhe në këtë zonë 25 për qind e tërmeteve ndodhin në botë. Pra, njerëzit duhet të kuptojnë që jemi në zonën ku do të ketë lëkundje herë pas here. Kjo fatkeqësi e rëndë lidhet ngushtë me gabimet në dhënie të licencës apo lejeve të ndërtimit, ku këto leje janë dhënë pafund dhe në baza miqësie. Pra, konkretisht moszbatimi i ligjit të ndërtimit gjithnjë do të shkaktojë kaos të madh", ka theksuar inxhinierja Bozo.

Në këtë konferencë foli edhe Hajriz Sejdiu nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave. Sejdiu ka thënë se vlerësimi i rrezikut është bazamenti i çdo intervenimi. "Vlerësimi i rrezikut është bazamenti i një

intervenimi. Ne duhet të shohim se sa jemi të përgatitur në rast tërmeti. Ne duhet t'i koordinojmë faktorët tanë që të menaxhojmë sa më mirë në rast të situatave tona. Kemi sfida dhe kemi ngecje në gatishmërinë tonë", ka thënë Sejdiu.

Ndërkaq nënkolonel Ejup Maqedonci nga Forca e Sigurisë së Kosovës ka njoftuar se FSK-ja është një nga forcat më profesionale. Sipas kolonel Maqedonci, fokusi i miqve ndërkombëtarë ka qenë që Forca e Sigurisë të trajnohet për intervenime të shpejta. Në emër të grupit të UBT-së që qëndroi në Durrës për vlerësimin e objekteve pas tërmetit, prof. dr. Visar Krelani dhe prof. Arsim Rapuca, gjatë konferencës prezantuan të gjeturat dhe rezultatet e vlerësimit të objekteve dhe shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit, me magnitudë 6.4 shkallë rihter.

## Prokurori në Mitrovicë kërkon që dy shtetasit rusë të gjobiten me para

MITROVICË, 14 JANAR - Policia e Kosovës ndaloi dy shtetas rusë në veri të Kosovës, një burrë dhe një grua, nën dyshimet se kanë kaluar ilegalisht kufirin Serbi-Kosovë.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Sllobodan Bakiq, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ka kërkuar dënim të detyrueshëm (gjobë me para) për shtetasit rusë dhe se vendimi pritet gjatë ditës. Sipas burimeve të "REL"-it, shtetasit rusë u kanë thënë autoriteteve të Kosovës se kanë synuar të arrijnë në Llukovska Banja - qendër rehabilituese në jug të Serbisë, në afërsi të vend-



kalimit kufitar të Jarinës dhe se sistemi i navigimit i ka dërguar

në kufi me Kosovën. Ata kanë thënë se nuk kanë

planifikuar të hyjnë në Kosovë. Prokurori Bakiq kishte thënë më herët se ata fillimisht kanë bërë përpjekje ta kalojnë vendkalimin kufitar Jarinë porse, për shkak të mungesës së vizave, janë kthyer.

Pas përpjekjes së sërishme për të shkuar në banjë, ata kanë shfrytëzuar rrugë alternative dhe janë kapur nga policia. Prokurori i identifikoi ata si Egor Igoreviq (Igor Krasikov) dhe Marina Vladimirovna Krasikova. "Dy shtetasit rusë u përpoqën të hyjnë në territorin e Kosovës, por nuk i plotësonin kushtet për këtë, sepse nuk kishin vizë dhe leje qëndrimi,

pra mundësinë e qëndrimit në Kosovë. Pastaj, ata përdorën një rrugë alternative në fshatin Sharpel dhe u përpoqën ta kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme. Aty u kapën nga një patrullë, u ndaluan dhe u proceduan penalisht. Kam vendosur masën e paraburgimit prej 24 orësh. Ne po punojmë në këtë çështje dhe ka të ngjarë që ata të paraqiten para gjykatës pasdite", ka thënë Bakiq. Policia ka njoftuar më herët se dy shtetasit rusë kanë qenë duke udhëtuar me një automjet me tabelë të Malit të Zi. Me urdhër të prokurorit, vetura është konfiskuar.

## Trusti arrin 161 milionë euro kthim nga investimet

PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) mjetet nën menaxhim kanë shënuar rritje të lartë, e cila kap shifrën e rreth dy miliardë eurove dhe shënon një rritje vjetore prej 300 milionë eurosh. Kështu është bërë me dije të martën në një konferencë për medie që kanë mbajtur drejtuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale. Kryesuesi i Bordit të Trustit, Ruzhdi Morina, ka deklaruar se Fondi për vitin 2019 ka arritur një

performancë pozitive nga investimet prej 8.9 përqindësh, ndërkohë që e ka mbajtur luhatshmërinë e ulët. Sipas tij, kthimi bruto ka shkuar në rreth 161 milionë euro në total, duke qenë kështu në vlerë nominale më i lartë ndonjëherë. Ndërsa në vitin 2018 kthimi në investime ishte 84.7 milionë euro ose minus 5.3 për qind.

Morina ka thënë se pothuajse 75 për qind e mjeteve të FKPK-së gjatë vitit 2019 ishin investuar në

tregjet financiare ndërkombëtare. "Edhe pse viti u përmyll me rritje të fortë të performancës së tregjeve, përgjatë vitit ishin disa rriske dhe pasiguri me vlerësimin shumë të lartë të aksioneve, me përkeqësimin e fitimit të pritshëm të korporatave", u shpreh ai. Sipas tij, 25 për qind e mjeteve ose rreth 500 milionë euro janë në tregun e Kosovës, kurse 75 për qind e mjeteve të tjera janë të koncentruara në tregun e BE-së dhe ShBA.



## Porti i Durrësit në funksion të Kosovës, përpunimi i mallrave rritet me 110,6 për qind



DURRËS, 14 JANAR - Hapja e pikës doganore të Kosovës në portin e Durrësit ka dhënë rezultate të menjëhershme pozitive. Sipas shifrave të bëra publike nga

Autoriteti Portual, vetëm për vitin 2019 vihet re një rritje prej 110,6 përqindësh të përpunimit të mallrave transit me destinacion Kosovën.

Rreth 31 anije dhe 106,000 tonë mallra me destinacion Kosovën janë përpunuar në port përgjatë vitit që lamë pas. "Gjatë 2019-s konstatohet një rritje prej 110,6

përqindësh në përpunimin e mallrave transit me destinacion Kosovën krahasuar me vitin paraardhës. Në portin më të madh të vendit gjatë vitit që lamë

pas janë përpunuar 31 anije dhe 106,000 tonë mallra transit të cilat janë nisur drejt Kosovës", thuhet në njoftimin e Autoritetit Portual të Durrësit.

## Ngërçi politik ka krijuar dëme të mëdha ekonomike që nuk riparohen me vite

PRISHTINË, 14 JANAR - Kriza politike në Kosovë si pasojë e vonësës për formimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit ka krijuar efekte shumëdimensionale në fushën e ekonomisë dhe pritet që ky do të jetë një vit i vështirë për vendin tonë.

Ngërçi politik me të cilin po ballafaqohet shteti ynë tash e sa muaj, sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka efekte negative në të gjitha proceset në shoqëri në përgjithësi, por edhe të

ekonomisë në veçanti.

Rukiqi në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se është hera e tretë që vendi ka situatë të tillë me vonesa paszgjedhore për konstituimin e qeverisë që, sipas tij, po e bën të pamundshëm funksionimin e qeverisë dhe parlamentit.

Ky vakum institucional, sipas Rukiqit, nuk paraqet problem vetëm për buxhetin e shtetit, por rreziku është edhe te depresioni ekonomik që paraqet pasoja në mbarë shoqërinë.

Kreu i OEK-ut ka shtuar se në

bazë të hulumtimeve të bëra më parë, edhe në periudhat e kaluara kur ka pasur ngërçe politike dhe gazlotsjellës në Kuvend, ka pasur një ulje të dukshme të konfidencës të të bërit biznes vend, edhe nga ana e kompanive vendore dhe ato të huaja, andaj këto rrethana politike aktuale reflektojnë në gjithë sektorët. Rënia e investimeve të huaja, papunësisë dhe eksporteve, sipas Rukiqit, janë elementet që ndërliken me situatën aktuale në vend dhe riparimi i këtyre dëmeve merr kohë me vite.





# Qytetarëve u keqpërdoren numrat e telefonit nga kompani të ndryshme për qëllime marketingu

Të dhënat personale të qytetarëve po përdoren në mënyrë joligjore nga kompani të shumta, të cilat përmes tyre bëjnë marketing të drejtpërdrejtë duke promovuar produkte të ndryshme dhe duke përfituar. Qytetarëve në vendin tonë në mënyrë të paautorizuar dhe pa pëlqimin paraprak të tyre u keqpërdoren numrat e telefonit nga kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për qëllime marketingu. Njohësi për Siguri dhe Privatësi Kibernetike, Mentor Hoxhaj, ka thënë për "Epokën e re" se kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të privatësisë së personave të targetuar, ndërkaq kompanitë telefonike thonë se të dhënat e konsumatorëve janë të mbrojtura me ligje

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 JANAR** - Për qëllime marketingu agjentë të kompanive të ndryshme thërrasin qytetarët në numrat e tyre telefonikë për t'i proklamuar produktet e tyre, si fshesa të energjisë, pajisje të ndryshme teknologjike dhe shtëpiake. Kjo dukuri është bërë e shpeshtë në Republikën e Kosovës dhe mjaft shqetësuese për qytetarët.

Në Ligjin NR. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Neni 73, Marketingu i Drejtpërdrejtë, pika 2, thuhet se: "Për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kontrolluesit e të dhënave mund t'i përdorin vetëm të dhënat personale të grumbulluara në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni: emrin personal, adresën e vendbanimit të përhershëm ose të

përkohshëm, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike (e-mail). Në bazë të pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave, kontrolluesit e të dhënave mund të përpunojnë të dhëna të tjera personale, por të dhënat personale të ndjeshme mund t'i përpunojnë vetëm nëse ata e kanë pëlqimin me shkrim".

Një qytetar nga Vushtrria disa herë është shqetësuar nga telefonatat e ndryshme që ka marrë, duke apeluar te operatorët e telefonisë mobile dhe ARKEP-i që të marrin masa ndaj këtyre kompanive. "Kam pasur raste të shumta kur më kanë thirrur kompani të ndryshme dhe kur i kam pyetur ku e morët këtë numër apo kush ua rekomandoi numrin tim, më kanë thënë se e gjetën në internet këtë numër, gjë që nuk është e vërtetë, sepse nuk e kam të publikuar askund numrin. Këto

thirrje janë të bezdisshme dhe kompanitë e telefonisë mobile në Kosovë duhet të kenë mekanizma për t'i mbrojtur të dhënat personale të konsumatorëve të vet. Në të kundërtën, ARKEP-i duhet të ndërmarrë masa deri në gjobitjen e tyre", ka thënë L. K. për gazetën "Epoka e re".

Njohësi për Siguri dhe Privatësi Kibernetike, Mentor Hoxhaj, ka thënë se në rast se kemi të bëjmë me mospëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave, në të kundërtën kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të privatësisë së personave të targetuar. "Personat juridik, në këtë rast kompania gjermane duhet të kenë pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave. Që do të thotë duhet ta kenë pëlqimin e personave që dëshirojnë t'i thërrasin. Dhe në rast se personi ka dhënë pëlqimin, ai/ajo mund

të tërheqë në çdo kohë pëlqimin e dhënë dhe të kërkojë që në të ardhmen mos të shqetësohen nga thirrja, mesazhi apo çfarëdo lloj komunikimi i drejtpërdrejtë personal", ka thënë Hoxhaj për gazetën "Epoka e re".

Ai ka shtuar se në raste të tilla shqetësimi i parë është ku e kanë siguruar numrin e telefonit, në rastet kur personi i thirrur u drejtohet në emër. "Personat janë të shqetësuar se një kompani 'X' ka siguruar numrin e tyre të telefonit dhe ndihen të shqetësuar dhe të frikësuar. Kjo përbën shkelje të rëndë të privatësisë së personave të targetuar. Meqë me rastin e aplikimit të marketingut të drejtpërdrejtë është bërë shkelje e shumëfishtë e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", u shpreh Hoxhaj. Sipas tij, në rastet kur thirrja bëhet me numra të rastësishëm kemi vetëm shkelje të dispozitave ligjore sa i përket marketingut të drejtpërdrejtë.

Qytetari me inicialet A. Q nga Prishtina ka bërë me dije për "Epokën e re" se mbi dhjetë herë ka pranuar telefonata nga kompani të ndryshme për blerjen e produkteve të tyre. Ai ka thënë se këto telefonata janë shqetësim për të, pasi ka pasur raste kur edhe në orarin e punës e kanë thirrur. "Mbi dhjetë herë

kam marrë telefonata nga kompani të ndryshme. Ka pasur raste edhe kur kam qenë në orar të punës më kanë thirrur. Kjo është diçka jonormale të keqpërdoret numri personal i telefonit. Nuk e di se si kompanitë 'Vala' dhe 'Ipko' (sepse ka pasur rast kur kam pranuar telefonata edhe në 'Ipko') lejojnë t'ua japin listat e numrave të telefonit, sepse këta numra janë keqpërdorur nga dikush brenda këtyre kompanive telefonike", ka thënë A. Q.

Në Telekomin e Kosovës kanë thënë për "Epokën e re" se meqë numrat personalë janë të mbrojtur me ligj, "Vala" nuk i jep qasje në këtë asnjë lloj kompanie. "Të dhënat e konsumatorëve janë të mbrojtur me ligjet nga ana e operatorit 'Vala' dhe duke e pasur parasysh këtë, 'Vala' nuk i jep askujt qasje, pra asnjë kompanie qoftë vendore apo ndërkombëtare sa iu përket konsumatorëve tanë", është thënë në këtë përgjigje.

Po ashtu edhe në "IPKO" kanë thënë se numrat personalë të konsumatorëve janë të mbrojtur dhe s'dalin nga kjo kompani. "Kompania jonë nuk jep të dhëna të tilla. IPKO-ja nuk jep asnjë të dhënë te klientëve të vet dhe të asnjë kompani të tretë", është thënë në përgjigjen e "IPKO"-s.



# Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit

*Naim Krasniqi paralajmëron ndryshimin e të kuptuarit të sotëm mbi polet magnetike, fushën magnetike, burimin dhe shpërndarjen e kësaj fushës magnetike*



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Koncepti i sotëm i shkencës mbi polet magnetike është i gabuar, në kuptimin se nuk i përgjigjet realitetit. Realiteti i ri është krejt ndryshe: fushat magnetike burojnë njëkohësisht nga të dyja polet magnetike të një magneti apo elektromagnetit dhe asnjëherë nuk kthehen më aty prej nga kanë buruar. Prej kësaj buron e reja tjetër: fushat e ndryshme rigjenerohen, me çka ndryshohet kuptimi i ligjit mbi ruajtjen e energjisë.


Një prurje e re është fakti se secili trup qiellor rreth të cilit rrotullohet të paktën një trup qiellor përbëhet nga pesë sfera. Për shembull, nga polet magnetike të tokës burojnë katër fusha magnetike, kurse një fushë antimagnetike buron jashtë poleve magnetike të tokës.

Një risi tjetër konceptuale është të kuptuarit se sferat e trupave qiellorë jashtë qendre janë të mbushura me energji të zezë. Secila sferë ka një ADN të caktuar. Energjia e zeze është e mbyllur nëpër sferat elastike, që kanë kufij elastik. Galaktika jonë është

vetëm një sferë elastike brenda një sfere tjetër. Përmes një qasjeje të re kuptohet se energjia brenda një sistemi të mbyllur, mund të shndërrohet nga një formë në një formë tjetër, dhe secila formë shndërrohet në punë. Ky shndërrim brenda një sistemi shkakton rritjen e energjisë e cila transformohet në rritjen e punës.

## Anomalitë e fushës magnetike

Gjatë historive të ndryshme të zbulimeve shkencore, shpeshherë thuhet se komuniteti shkencor është pajtuar me ndonjë të arritur shkencore sado e gabuar të ketë qenë. Ky komunitet shkencor e ka





të hekurit (Fe) mbi këtë pllakë. Gjithashtu pluhuri i hekurit ka në përbërjen e tij fije të vogla cilindrike të hekurit, që na shërbejnë për ta kuptuar më mirë orientimin e këtyre fijeve të hekurit në fushën magnetike. Shiko figurën 1. a).

## Analiza e parë i fushës magnetike

Duke u bazuar në këtë eksperiment vërejmë disa detaje që mund të konsiderohen si elemente kryesore të fushës magnetike, por që ju ka ikur shkencëtarëve nga vëmendja. Kjo ka të bëjë me burimin e fushës magnetike nga poli magnetik i veriut, dhe hyrjen e saj në polin magnetik të jugut (S), ashtu sikur shkenca e paramendon deri në ditët e sotme. Kjo nënkupton se dipolet magnetike (dm) si bartëse të fushës magnetike, ashtu sikur shkenca e paramendon burojnë nga poli magnetik i veriut dhe hyjnë në polin magnetik të jugut (S).

Por siç po shihet një pjesë e vijave të fushës magnetike që buron nga poli magnetik janë perpendikulare me sipërfaqen e këtij poli prej nga buron fusha magnetike. Që do të thotë se



marrë si vendimtar dhe të suksesshëm ndonjë arritje shkencore mbi një fenomen të caktuar.

Në këtë mënyrë ky komunitet shkencor me vetëdije apo pa vetëdije thuhet se i ka mbyllë dyert ideve të tjera që i kontestojnë këto vendime qoftë edhe tejet të pasakta nëse janë. Një ndër këto fenomene është edhe të kuptuarit e fushës magnetike. Prandaj fusha magnetike e tanishme shkencërisht mendohet se njihet

magnetik të jugut (S). Në këtë mënyrë edhe kuptimi i fushës magnetike e cila buron nga poli magnetik i veriut dhe hyjnë në polin magnetik të jugut (S), është marrë si një problem që ishte zgjidhur shumë kohë më parë. Mbi këtë bazë, realisht shumë zgjidhje janë bërë në kundërshtim me ligjet e natyrës në të cilën jetojmë. Se sa ne e kuptojmë realitetin e fushës magnetike, duhet t'i drejtohem natyrës, ashtu që vetë natyra të flet dhe të na bindë mbi vërtetësinë e këtij fenomeni.


Duke u bazuar në një rastësi që më ka ndodhur po në këtë natyrë qoftë e paqëllimshme apo aksidentale kam zbuluar fushën antimagnetike, e cila fushë magnetike më ka dërguar te fusha antielektrostatike.

Por fusha antielektrostatike më riktheu në pikën fillestare, te

fusha magnetike. Kthimi te fusha magnetike më mori përpara shumë ndryshime mbi të kuptuarit e logjikshëm dhe të bazuar në ligjet e natyrës të fushës magnetike.

Mbështetur në eksperimente të shumta, kam arritur në përfundim se të kuptuarit e fushës magnetike, ashtu sikurse e njeh fizika e tanishme, nuk është në përputhje me proceset që ndodhin në natyrë. Shih për këtë, personalisht e kontestoj konceptimin e tillë të fushës magnetike, të cilën edhe vetë e kisha pranuar si të vërtetë deri para disa vitesh.

## Polet e fushës magnetike




## të magnetëve permanent

### Eksperiment 1

Në këtë eksperiment të thjeshtë dhe të kuptueshëm më mirë e marrim një magnet cilindrik (M). Mbi këtë magnet vendosim një pllakë të hollë nga plastika, e cila nuk ndikon në fushën magnetike. Pastaj gradualisht e shpërndajmë pluhurin e hekurit

këto dipole magnetike (dm) që burojnë nga ky pol magnetik mbyllin këndin 90° shkallë me sipërfaqen e këtij poli magnetik ashtu sikur shihet në figurën 1. b).

Nga ana e tjetër bazuar në të njëjtën figurë 1. a), vijat e fushës magnetike që burojnë nga qendra e poli magnetik të veriut përshkruajnë një rrugë afërsisht të drejtë, të cilat e kanë formën e





## Rrënohet një objekt pa leje në qendër të Prishtinës

PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka rrënuar një objekt pa leje në rrugën "Fehmi Agani", konkretisht afër Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Kjo komunë ka bërë me dije se ka paralajmëruar se do t'i presë fati i njëjtë të gjithë ata që do të ndërtojnë pa leje ndërtimore. "Javë më parë, mbi objektin e ndër-

tuar me leje, ka filluar ndërtimi i katit shtesë përtej lejes ndërtimore. Pavarësisht prej urdhërësive të inspektorëve për ndërprerje të punimeve, pala ka vazhduar ndërtimin, me ç'rast më 6 janar i është dhënë aktvendimi për rrënim dhe i është shqiptuar gjoba. Meqë as pas këtyre masave pala nuk është bindur, por ka vazhduar

ndërtimin, inspektorët bashkë me Policinë e Kosovës dhe kompaninë e kontraktuar kanë filluar sot ta rrënojnë mbindërtimin pa leje. Komuna tashmë ka nënshkruar kontratë afatgjatë me kompaninë për rrënim. Kushdo që tenton të punojë në këtë formë do ta ketë fatin e njëjtë!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.





një konusi, maja e të cilit kalon nëpër qendrën e sipërfaqes së magnetit. Kurse konusi mbyllë një kënd afërsisht 45° shkallë nga qendra në drejtim të periferisë rreth të sipërfaqes së jashtme të magnetit në formë cilindri. Shiko figurën 1. c). Kurse shpërndarja e kësaj fushe magnetike që buron nga poli magnetik i veriut është e qartë, sepse shihen se grimcat e hekurit të cilat janë magnetizuar janë të shpërndara ashtu sikur shpërndahet fusha magnetike.

### Analiza e dytë e fushës magnetike

Tërësisht ngjashëm i njëjti proces na paraqitet edhe te poli magnetik i jugut (S). Në të njëjtën mënyrë shihet qartë se edhe mbi polin magnetik të jugut (S), vijat e fushës magnetike shpërndahen në mënyrë identike ashtu sikur janë shpërndarë mbi polin magnetik të veriut. Figura 1. d). Kështu që në mënyrë tërësisht të ngjashme vijat e fushës magnetike që burojnë edhe nga qendra e polit magnetik të jugut (S) përshkruajnë një rrugë afërsisht të drejtë, të cilat e kanë formën e një konusi, maja e të cilit kalon nëpër qendrën e sipërfaqes së magnetit. Kurse ngjashëm edhe te poli magnetik i jugut (S) konusi mbyllë një kënd afërsisht 45° shkallë nga qendra në drejtim të periferisë rreth të sipërfaqes së jashtme të magnetit në formë cilindri figura 1. d). Kurse shpërndarja e kësaj fushe magnetike që buron nga poli magnetik i jugut (S) është gjithashtu e qartë, sepse edhe në këtë rast shihen se grimcat e hekurit të cilat janë magnetizuar, janë të shpërndara tërësisht ngjashëm edhe rreth polit magnetik të jugut ashtu sikur te poli magnetik i veriut (N).

### Ngjashmëria në mes qendrave të poleve magnetike

#### Argument i parë

Siç po shihet nga fotografia e parë eksperimentale, vërtetohet qartë se janë tërësisht të ngjashme fusha magnetike mbi polin e veriut dhe fusha magnetike mbi polin magnetik të jugut (S). Kështu që eksperimentalisht vërtetohet se kemi një simetri të qendrave përkatësisht konuseve mbi të dy polet magnetike. Prandaj nëse fusha magnetike do të buronte nga poli magnetik i veriut ashtu sikur pretendohet sot nga shkenca, absolutisht nuk do të kishte marrë pluhuri i hekurit pamje të njëjtë mbi të dy polet magnetike, përkatësisht nuk do të kishim dy forma të konuseve identike mbi të dy polet magnetike.

### Analiza e tretë e fushës magnetike

Mbi polin magnetik të veriut edhe pse e kam hedhur pluhurin e hekurit (Fe) në të gjithë hapësirën përmbi magnetin cilindrik, shihet se pluhuri i hekurit është bartur nga pjesa e afërt në drejtim të periferisë mbi polin magnetik të veriut, duke e lënë një zbrazëtirë (a) mbi pjesën e polit magnetik të veriut. Kështu që në pjesën (a) mbi polin magnetik të veriut (N) nuk ka pluhur sepse është bartur një pjesë e pluhurit të hekurit mbi trupin e magnetit, kurse pjesa e tjetër është bartur në drejtim të periferisë ashtu sikur shihet në figurën 1. e). Duke u bazuar në këtë pjesë eksperimentale, themi se forca e fushës magnetike e cila buron nga poli magnetik i veriut konsiderohet si një forcë shtytëse, dhe pikërisht kjo forcë shtytëse e fushës magnetike e largon pluhurin e

hekurit nga pjesa (a). Kurse kjo pjesë me qendrën e polit magnetik të veriut e formon një kënd rreth 45° shkallë. Prandaj eksperimentalisht vërtetohet se largimi i pluhurit nga pjesa (a) tregon qartë se fusha magnetike buron nga poli magnetik i veriut, ashtu sikur shkenca e thotë edhe në ditët e sotme.

### Analiza e katërt e fushës magnetike

Po të bazohemi në fushën magnetike të tanishme, do të duhej që kjo fusha magnetike që buron nga poli magnetik i veriut do ta largonte pluhurin e hekurit nga pjesa (a), dhe do ta barte mbi trupin e magnetit dhe do ta barte në drejtim të polit magnetik të jugut (S), dhe gjithsesi pluhuri do të gjendej para pjesës (c) të polit magnetik të jugut (S) ashtu sikur shihet në figurën 1. f). Kurse eksperimentalisht vërtetohet se pamja e pjesës (c) mbi polin magnetik të jugut (S), shihet se është identike me pamjen e pjesës (a) që ndodhet mbi polin magnetik të veriut, kurse pluhuri i hekurit mungon mbi të dy pjesët (a) të polit magnetik të veriut, dhe pjesës (c) të polit magnetik të jugut (S). Çka do të thotë se në mënyrë identike fusha magnetike nga poli magnetik i jugut (S) me forcë e ka larguar pluhurin e hekurit nga sipërfaqe (c) duke e bartur një pjesë drejtë periferisë, kurse pjesën tjetër e ka bartur mbi trupin e magnetit cilindrik. Por ky eksperiment hedhë dritë mbi fushën reale magnetike që vepron mbi polin magnetik të jugut (S). Ky është një argument se po mos të buronte edhe fusha magnetike nga poli magnetik i jugut (S), nuk do të kishim një pamje të ngjashme mbi pjesën (a) dhe (c) të poleve magnetike. (VIJON)



## Haziri: 'Flaka e Janarit 2020' i kushtohet kryengritësit Abdullah Tahiri

**GJILAN, 14 JANAR (ER)** - Në Gjilan ka filluar "Flaka e Janarit", një manifestim ky kulturor, përmes të cilit kujtohen e nderohen heronjtë e kombit që nga periudha e Skënderbeut e deri te lufta e UÇK-së. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, nën përkujdesjen e të cilit është duke u mbajtur ky manifestim, ka thënë se "Flaka e Janarit 2020" i kushtohet kryengritësit të Anamoravës, kolosit të kombit Abdullah Tahiri, në 21-vjetorin e rënies së tij. "Abdullah Tahiri ka qenë një njeri i drejtpërdrejtë dhe impul-

siv, i cili ka shpërthyer gjithmonë kundër padrejtësive. Abdullahu i përket grupit të njerëzve të mirë, të njerëzve të mëdhenj që edhe me aktin e sakrificës personale, ka zënë vendin meritot në rreshtin e madh të kolosëve të kombit", ka thënë Haziri. "Flaka e Janarit 2020", që është hapur me nderjen e flakadanëve dhe një akademi kushtuar dëshmorit Xhevat Qerimi, do të vazhdojë deri më 31 janar, me aktivitete të tjera, në katër shtyllat kryesore të këtij manifestimi, që u kushtohet heronjve dhe të rënëve për liri.

## Mbahet dëgjimi publik për çështjen e banimit social në Suharekë

**SUHAREKË, 14 JANAR (ER)** - Në sallën e Asamblesë Komonale të Suharekës është mbajtur debati publik me qytetarë për banimin social në kuadër të programit trevjeçar të banimit. Qëllimi i hartimit të këtij programi për banim është adresimi i çështjeve të banimit social në territorin e Komunës së Suharekës. "Duke krijuar kushte për banim të përshatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, Organizata 'Developing Together' ka prezantuar planin e projektit për banim social para të pranishmëve", ka njoftuar Komuna e Suharekës. Ndërkaq drejtoresha e



Shëndetësisë në Komunën e Suharekës, Sale Bytyqi, ka folur për rëndësinë e këtij projekti. "Ne si komunë dhe si Drejtori e Shëndetësisë e kemi obligim ligjor t'u dalim në ndihmë qytetarëve që kanë nevojë për banim social dhe të gjithë ata që përballen me këto sfida luten të drejtohen tek institucionet përkatëse", ka thënë Bytyqi.

## Koordinatori Hoti shpërndan libra në Viti dhe Han të Elezit

**VITI, 24 JANAR (ER)** - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, u ka dhuruar 350 sete librash në vlerë prej 50 eurosh nxënësve në Komunën e Vitisë dhe Hanit të Elezit. Të gjithë këta nxënës ishin

fitues të garës Nationale në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik dhe garës Nationale të Diturisë. Në Viti e Han të Elezit, me rastin e ndarjes së shpërblimeve, koordinatori Hoti theksoi rëndësinë e garës dhe të arsimit, duke thënë

se këto komuna kanë qenë shembull i mirë i organizimit. Edhe drejtoresha komunale e Arsimit në Viti, Fatbardha Emini, duke falënderuar Hotin për librat, foli për rëndësinë e shpërblimit si formë motivuese për nxënësit.



## Dhoma e Përfaqësuesve dhe dërgimi në Senat i akuzave për shkarkimin e presidentit

WASHINGTON, 14 JANAR - Dhoma e Përfaqësuesve pritet të votojë sot (e mërkurë) për t'i dërguar në Senat akuzat për shkarkimin e presidentit Trump, duke lejuar fillimin e gjykimit të presidentit. Kjo është hera e tretë në histori që në Senat zhvillohet gjyqi për shkarkimin e një presidenti. Në një mbledhje me dyer të mbyllura të martën me ligjvënësit demokratë, Pelosi bëri të ditur planin e saj për

të emëruar të mërkurën ekipin e ligjvënësve që do të luajnë rolin e prokurorit në gjyqin që zhvillohet në Senat. Procesi gjyqësor drejtohet nga kryetari i Gjykatës së Lartë, ndërsa senatorët janë në rolin e anëtarëve të jurisë që ka në dorë të shpallë presidentin të fajshëm ose jo, për akuzat e ngritura nga Dhoma e Përfaqësuesve. Republikanët, që kanë shumicën në Senat, i kanë kundërshtuar akuzat kundër

presidentit Trump dhe nuk pritet që ai të shpallet fajtor. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Pelosi, priti katër javë për t'i dërguar akuzat në Senat, gjë për të cilën ajo është kritikuar nga republikanët. Pelosi thotë se ajo kërkonte të dinte më shumë hollësi rreth mënyrës se si do ta zhvillonin procesin gjyqësor republikanët, duke i akuzuar ata për bashkëpunim me presidentin për ta shpallur atë të




pafajshëm. Dy presidentët e tjerë në të kaluarën që i janë nënshtruar gjyqit në Senat, janë Bill Clinton në vitin 1999 dhe Andrew Johnson në 1868-n.

## Ajova dhe debati i kandidatëve demokratë për president

Më 3 shkurt, në më pak se tri javë, Ajova bëhet shteti i parë që zhvillon votimet paraprake për emërimin e kandidatëve për president, për të vazhduar më tej në gjithë shtetet e tjera

Washington, 14 janar - Kandidatët demokratë për postin e presidentit kanë zhvilluar një debat të rëndësishëm të martën në shtetin Ajova. Më 3 shkurt, në më pak se tri javë, Ajova bëhet e para që zhvillon votimet paraprake për emërimin e kandidatëve për president, për të vazhduar më tej në gjithë shtetet e tjera. Gjashtë konkurrentë demokratë ishin në debat ndërsa duken shenja të rritjes së tensioneve mes tyre. Debat i vjen në një kohë kur janë shtuar tensionet ushtarake me Iranin, si dhe afrimi i procesit gjyqësor ndaj presidentit Trump në Senat, ka njoftuar voa. Mes konkurrentëve ishte edhe kryesuesi i garës së demokratëve në anketat kombëtare, ish-zëvendëspresidenti Joe Biden. Bideni është përqendruar te siguria kombëtare duke pasur parasysh zhvillimet e fundit me Iranin. "Prandaj është kaq e rëndësishme të zgjedhim dikë që është i gatshëm që nga momenti që është zgjedhur, të përmirësojë këtë

çrregullim dhe menjëherë të bëhet komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura", tha ai. Bideni ndodhet përballë një sfide të fortë në shtetet e para që zhvillojnë votime paraprake si Ajova dhe Nju Hampshire, kryesisht nga senatori Bernie Sanders i shtetit Vermont. Anketat tregojnë se Sanders kryeson në Ajova. "Shumë njerëz kanë të ardhura të pamjaftueshme. Dhe nuk bëhet fjalë për të përballuar një shtëpi apo makinë të mirë, bëhet fjalë për të mbijetuar nga dita në ditë, pa e ditur nëse javën që vjen do të keni mundësi të ushqeni fëmijët apo paguani faturat e dritave", tha ai. Tensionet po shtohen mes Sandersit dhe disa të kandidatëve të tjerë, përfshi senatorin Elizabeth Warren të shtetit Masaçusets. Sondazhet e fundit tregojnë se Warren ka pasur rënie ndërsa gëzon popullaritet në Ajova dhe Nju Hampshire. "U zhgënjeva kur dëgjova se Bernie po dërgon



vullnetarët e tij për të më shkatërruar. Demokratët duhet të bashkohen dhe kjo do të thotë afrimi i të gjitha pjesëve të koalicionit demokrat", tha ajo. Por Sanders i ka mohuar akuzat. Një kandidat tjetër i fuqishëm në votimet e hershme është edhe kryebashkiaku i qytetit South Bend të Indianës, Pete Buttigieg. Ai është përqendruar tek uniteti kombëtar. "Kërkohej një lloj tjetër patriotizmi dhe angazhimi për sigurinë kombëtare. Një dashuri për vendin, që fillon me pranimin se vendi

ynë përbëhet nga njerëz, dhe nuk mund ta duash vendin nëse urren gjysmën e popullsisë. Po flas për diçka më të mirë", tha Bend. Ish-kryebashkiaku i qytetit të Nju Jorkut, Michael Bloomberg nuk është kualifikuar për debatet, por ka pasur rritje në anketa pas një fushate masive me reklama televizive, me shpresën për të konkurruar në zgjedhjet paraprake të marsit. "Di si të hap vende pune dhe ndërtoj biznese, jo sepse kam luajtur një udhëheqës biznesi

në një shfaqje televizive, por sepse kam qenë një i tillë në jetën reale", tha ai. Gara në shtetin Ajova duket të jetë e hapur për momentin, thotë analisti John Fortier. "Gara është e hapur por qartazi Joe Biden kryeson dhe nëse nuk pëson rënie në garat e hershme, ai duket mjaft i fortë", tha ai. Ritmi i fushatës do të intensifikohet gjatë javëve në vazhdim, ndërsa votuesit në Ajova dhe Nju Hampshire bëhen gati që t'i bëjnë vlerësimet paraprake ndaj konkurrentëve demokratë.

## Daçiqi: Raportet Serbi - Mal i Zi janë shumë të këqija

BEograd, 14 JANAR - Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiq, tha se marrëdhëniet midis Beogradit dhe Podgoricës janë shumë të këqija për shkak të miratimit të Ligjit malazez për lirinë e fesë duke shtuar se kushdo që e pranon këtë ligj në Serbi e "tradhton vendin e tij". "Ai që e toleron këtë ligj, e tradhton vendin e tij, por problemi është se këtu bëhet fjalë për qarqe interesi", tha Daçiqi. Ai hodhi poshtë akuzat e një grup intelektualësh nga ish-Jugosllavia, të cilët, përmes një

apeli, thanë se Beogradi po kërcënonte paqen dhe stabilitetin në Malin e Zi dhe rajon. Në këtë apel i kërkohej komunitetit ndërkombëtar t'i dënojë fushatat politike, të kishës dhe mediave në Serbi. "Asnjëherë nuk kemi thënë që duam që Mali i Zi të jetë i bashkuar me Serbinë, e as nuk kemi miratuar ndonjë akt që do të kishte ndonjë lidhje me marrëdhëniet e brendshme në Mal të Zi. Malaziasit vazhdimisht pretendojnë se Serbia kinse dëshiron të jetë përsëri në të njëjtin shtet me Malin e Zi. Jo se ne nuk



duam, por është një histori e mbaruar", tha Daçiqi. Ai deklaroi se Serbia ka shprehur pakënaqësinë e saj për miratimin e ligjit, për të cilin beson se ishte drejtuar kundër popullit serb dhe Kishës Ortodokse Serbe, dhe u kërkoi autoriteteve malazieze që të zgjidhin problemin në paqe dhe dialog. Mali i Zi miratoi Ligjin për Lirinë e Fesë, më 27 dhjetor 2019. Ligji kundërshtohet fuqishëm nga Kisha Ortodokse Serbe, zyrtarë dhe një pjesë e opozitës në Serbi.



# Promovohen dy libra të Gani Sylajt botuar pas vdekjes së tij

Në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" sot janë promovuar dy libra të Gani Sylajt të lënë dorëshkrim: libri me tregime "Shenja e përkatësisë" dhe ai i kujtimeve, "Burg pas burgu", vazhdim i librit "Ilegal viteve shtatëdhjetë", që autori e botoi për së gjalli. Folësit thanë se të dy librat kanë rrëfime që dëshmojnë përkushtimin e autorit



**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 JANAR - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" janë promovuar të martën dy libra të Gani Sylajt të lënë dorëshkrim, libri me tregime "Shenja e përkatësisë" dhe ai i kujtimeve,



autorit Gani Sylaj. Me këtë të fundit Krasniqi ka qenë koleg në shkollë. "Të dy librat që kemi sot para vetes kanë rrëfime që dëshmojnë përkushtimin e autorit se duhet thënë për frymën që formoi ai për tërë jetën e tij. Autori nuk arriti t'i botonte dy librat, por vetëm një libër. Na gëzon fakti se Ganiu la pas vetes dy libra dhe disa shkrime që presin për botim. Latinët e lashtë kanë thënë se fjalët i merr era e shkrimet mbesin. Jam i bindur se secili lexues do të bindet se çfarë ishte një shtet i huaj. Me Ganiun nisëm rrugën jetësore dhe aspak të lehtë, atë të mësue-

sisë. Ne që kemi qenë me vite në këto burgje e dimë se çfarë do të thotë libri në ato vende. Bota kishte parë djegien e librave dhe shteti policor i burgoste lexuesit", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se librat e përruar sot dëshmojnë luftën e bijve shqip-

ka thënë se këta libra hyjnë në librat më të rëndësishëm për ta përkujtuar të kaluarën. "Këta dy libra hyjnë në librat e rëndësishëm, sepse pa ta nuk mund ta përkujtojmë të kaluarën. Po ta lexosh këtë libër është si të jetosh në ferr, por ka edhe një

të dhunës fizike e psikike të inspektorëve të UDB-së. "Librat e autorëve të veçantë për nga kontributi që kanë dhënë në lëvizjet kombëtare janë burimet më të vlefshme krahas dokumenteve për ta shkruar historinë e atyre lëvizjeve. Autori i librit, duke rrëfyer në vetën e parë, por duke folur më shumë për shokët e vet dhe rrethanat e rënda të dhunës fizike e psikike të inspektorëve të UDB-së, ka përshkruar shumë më mirë vështirësitë në ato burgje", ka deklaruar Gashi.



tarë për luftën për çlirim dhe për liri, të cilat tregojnë jetën e vështirë të atdhetarëve në burgjet e Serbisë.

Kritiku nga Tirana, Behar Gjoka,

dritë. Ajo është liria", ka thënë ai. E profesor Ibrahim Gashi ka theksuar se autori ka përshkruar shumë më mirë vështirësitë në ato burgje dhe rrethanat e rënda

Ndërkaq drejtori i Institutit Albanologjik të Kosovës, Hysen Matoshi, ka folur për autorin e librit Gani Sylaj, duke theksuar se autori me këtë libër identifikoi vuajtjet e qindra të burgosurve. Ismail Sylaj, vëllai i autorit Gani Sylaj, ka falënderuar të pranishmit dhe është ndier mirënjohës për praninë e tyre. Për fund aktori i njohur Çun Lajçi lexoi pjesë të librit "Burg pas burgu".



**E jashtëzakonshme**

## Dubai bëhet me hotelin më të lartë në botë

Dubai, që është një qytet i njohur për ndërtesat e larta, pritet të jetë "shtëpia" e hotelit më të lartë në botë, "Ciel Tower". Ky hotel në rrugën Sheik Zayed është i lartë 360 metra dhe është interesant se Dubai tashmë është "shtëpia" e tashmë gjashtë hoteleve më të larta në botë. Gara për ndërtesa të larta në këtë vend filloi në vitin 1999, kur u hap "Burj



Al Arab", hotel ky që ishte 321 metra i lartë dhe konsiderohej më i larti në botë.

**FOTO E DITES**



Gara me vetura në Dakar në Arabinë Saudite. /AFP/

**E rrallë**

## Aeroporti i Stambollit nis shërbimin e kabinave të gjumit

Në Aeroportin e Stambollit ka filluar shërbimi i kabinës së gjumit, që tashmë gjendet në shumë aeroporte në botë. Pasagjerët që presin fluturimet e tyre në Aeroportin e Stambollit do të mund të marrin me qira kabina të gjumit të quajtura "IGA Sleepod", të cilat do të mund t'i



përvetësojnë duke paguar çdo orë për to. Kabinat do të mund të merren në përdorim me 9 euro për orë.

**BARSOLETA E DITËS**



**Policia dhe banka**  
 - Alo! Policia?!  
 - Po. Urdhëroni?!  
 - Është duke ndodhur një grabitje në një bankë.  
 - Në cilin vend?  
 - Në Prishtinë. Për sa vini?  
 - Për 15 minuta.  
 - Faleminderit, se po fillojmë grabitjen.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00**  
**Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



**Në ora 18:00**  
**Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan



**Çdo natë në ora 20:00**  
**STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams




**Çdo natë në ora 22:30**  
**THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Në luftën midis detyrës dhe kënaqësisë, ajo që fiton është detyra. Ju dëshironi të ndiheni të përbushur dhe i vlerësuar.</p>	 <p><b>DEMI</b> Marrëdhënia në çift tregon një hezitim të vogël, por dialogu si seksi vepron në mënyrë efektive.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Projektet që keni, kërkojnë shumë ambicie dhe përkushtim, kështu që bëni veten të disponueshëm në grupe dhe ambiente të ndryshme njerëzish.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Do ta keni mundësinë ta rindërtoni dashurinë dhe të merrni atë që nuk keni pasur në të kaluarën.</p>	 <p><b>LUANI</b> Aftësia juaj për të planifikuar dhe rregulluar gjithçka do të jetë e dukshme qartë. Mbi të gjitha, saktësia juaj do të vihet re.</p>	 <p><b>VIrgjëresha</b> Ju keni ide shumë të qarta në lidhje me atë që dëshironi të bëni dhe si ta merrni atë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot do të zhgënjeheni nga një mik dhe do të ndiheni i lënduar, por kjo nuk do të ndikojë në relaksim tuaj.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot do të përballeni me shumë dashuri në jetën tuaj. Do të jeni sociale dhe rreth vetes do të keni plot miq.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Pavëmendjet dhe shpërqendrimet do të jenë në rendin e ditës për shkak të Hënës në Virgjëreshë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Do të jeni i kënaqur pasi do të merrni disa lajme të mira dhe klientë të rinj. Do të jeni i lumtur me partnerin.</p>	 <p><b>UJORI</b> Organizoni më mirë aspektin operacion, së shpejti do t'i shihni përfitimet! Shijojeni shoqërinë e të dashurit tuaj pa lënë pas dore mirëqenien tuaj.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Kritikat ndaj miqve, sado të dashura, krijojnë ndërhyrje midis të dyve, mbase flasin për arsye të mira.</p>

## Mbretëresha Elizabeth II pajtohet me kërkesën e Meghan dhe Princit Harry



**M**bretëresha Elizabeth II i është përgjigjur kërkesës së Princit Harry dhe Meghan Marke për t'u 'larguar' si anëtarë të familjes mbretërore, sipas "Fox News". "Familja ime dhe unë jemi plotësisht mbështetës të dëshirës së Harry dhe Meghan për të krijuar një jetë të re. Megjithëse do të preferon-

im që ata të mbeteshin anëtarë të Familjes Mbretërore, ne gjithsesi e respektojmë dhe e kuptojmë dëshirën e tyre për të jetuar një jetë më të pavarur si familje. Harry dhe Meghan kanë bërë të qartë se ata nuk duan të mbështeten në fondet publike", ka thënë mbretëresha Elizabeth II.

## Jennifer Anistoni merr mbi nëntë milionë pëlqime në fotografinë e fundit



**Q**ë nga hapja e llogarisë në rrjetin social "Instagram", aktorja Jennifer Aniston po vazhdon të arrijë rekorde. Në fotografinë e fundit Aniston ka mbi nëntë milionë pëlqime. "Përshëndetje nga vajzat nga ana tjetër e korridorit",

ka shkruar Jenniferi, me fotografitë e ribashkimit të Phoebe, Monica dhe Rachel. Aniston ka hapur llogarinë e vet në "Instagram" duke postuar një fotografi të përbashkët me personazhet e Friendsit, ndërsa tani numëron 24 milionë ndjekës.



## Anwar dhe Dua më të dashuruar se kurrë

**Q**ë nga konfirmimi i lidhjes, Anwar Hadid dhe këngëtarja shqiptare Dua Lipa janë pjesë e përditshme e shtypit rozë. Mirëpo çifti çdo ditë e më shumë po dëshmon se janë më të dashuruar se kurrë. Së fundmi çifti ka udhëtuar në një vend

bregdetar prej nga fotomodeli ndau një imazh me të dashurën ku la edhe një mbishkrim mjaft romantik për të: "Ti je drita e diellit për mua". Ndërsa Dua nuk vonoi shumë dhe ia ktheu duke i thënë: "Drita e botës sime, të dua".

## Aktori i famshëm turk i propozon të dashurës martesë

**A**kin Akinozu, i njohur nga publiku shqiptar si Mirani në serialin "Hercai", së shpejti do t'i japë fund beqarisë. "Mirani" ka fituar zemrën e publikut shqiptar së bashku me partneren e vet "Rejanin", të cilët krijojnë një çift shumë të bukur. Edhe pse të gjithë fansat e tij do të donin që ai të kishte një lidhje në realitet me partneren e tij në serial, kjo gjë nuk do

të ndodhë. Akin Akinozu është prej pesë vjetësh i lidhur me një vajzë bionde e quajtur Sandra Pestemalciyan. Ajo është 24-vjeçare, e diplomuar në Universitetin Teknik të Stambollit, Departamenti i Ekonomisë. Sipas portalit "Aksam", Akini i ka propozuar martesë të dashurës gjatë pushimeve në Paris dhe thuhet se dasma do të bëhet këtë korrik.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Islami: E meritoja një ftesë, futbollistët u paraqitën mirë

Mbrojtësi Përparim Islami ka thënë për "Epokën e re" se e ka merituar të jetë pesë e Përfaqësueses në miqësoren ndaj Suedisë. "Normalisht se kam pritur ftesë nga përzgjedhësi, por nuk e kam marrë një të tillë. E respektoj vendimin e tij. Mua më takon të vazhdoj të punoj me ritëm të njëjtë dhe në të ardhmen besoj se do të jam pjesë e Përfaqësueses", ka thënë anëtar i Feronikelit, Përparim Islami



**"Epoka e re":** Rezultatet munguan në sezonin vjeshtor, por ndryshimet e mëdha jo. Pas këtyre ndryshimeve në radhët e futbollistëve, a është forcuar apo dobësuar Feronikeli?

**Islami:** Disa lojtarë janë larguar e disa të tjerë kanë ardhur. Tash është herët të jap një përgjigje adekuate, por mund të them se lojtarët e ardhur janë të rinj dhe me perspektivë. T'i shohim paraqitjet e tyre në pranverë dhe atëherë mund të kemi një përgjigje konkrete. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se disa lojtarë kanë nevojë për kohë më të gjatë për përshtatje me pjesën tjetër të ekipit.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 14 JANAR** - Përparim Islami është lojtari i dalluar i Feronikelit që nuk mori ftesë nga përzgjedhësi Bernard Challandes për ndeshjen miqësore kundër Suedisë. Ai në intervistë për "Epokën e re" është shprehur se e ka merituar të jetë pjesë "dardanëve", derisa ka lavdëruar për paraqitje lojtarët e Superligës. "Kosova e humbi ndeshjen, por paraqitja ka qenë e mirë, sidomos në pjesën e parë, ku dominoi kundërshtari. Ndërsa për shumicën nga lojtarët e Superligës që luajtën mund të them se kanë treguar paraqitje të mirë", ka thënë Islami.

është vlerësimi juaj për paraqitjet e tyre?

**Islami:** Loja me Suedinë ishte shumë e mirë. Për këtë ndeshje u ftuan edhe shumë lojtarë nga Superliga, për të cilët ishte një test shumë i mirë për t'u dëshmuar para përzgjedhësit Bernard Challandes. Kosova e humbi ndeshjen, por paraqitja ka qenë e mirë, sidomos në pjesën e parë, ku dominoi kundërshtari. Për shumicën e lojtarëve të Superligës që luajtën mund të them se kanë treguar paraqitje të mirë. Ky është një sinjal i mirë për trajnerin se mund të llogarisë edhe në lojtarët vendorë, kurse lojtarët do të jenë më të motivuar që të punojnë për të arritur të ftohen në Përfaqësuesë.

**"Epoka e re":** Përfaqësuesja e Kosovës në futboll zhvilloi miqësore me Suedinë. Për këtë ndeshje u ftuan 13 lojtarë nga Superliga dhe 9 prej tyre u paraqitën. Cili

**"Epoka e re":** Vitet e fundit keni treguar formë shumë të lartë, duke qenë një nga më meritoret për suksesin e Trepçës '89, pastaj ishit pjesë në sukseset e Feronikelit.

Megjithatë, kjo nuk mjaftoi që të merrni një ftesë nga Përfaqësuesja. Cili është koment i juaj?

**Islami:** Me të vërtetë vitet e fundit kam pasur paraqitje të mira dhe përgatitjet fizike ka qenë në nivel të lartë. Jam paraqitur mirë për Trepçën '89 dhe kemi arritur të dalim kampion dhe më pas kemi marrë pjesë në garat ndërkombëtare, pastaj u transferova te Feornikeli. Mirëpritja ka qenë e mirë. Edhe këtu kam pasur në vazhdimësi paraqitje të mira dhe me plot meritë arritëm t'i fitojmë të gjithë trofetë. Normalisht se kam pritur ftesë nga përzgjedhësi, por nuk e kam marrë një të tillë, por e respektoj vendimin e tij. Mua më takon të vazhdoj të punoj me ritëm të njëjtë dhe në

të ardhmen besoj se do të jam pjesë e Përfaqësueses.

**"Epoka e re":** Feronikeli, pavarësisht prej rezultateve të mira në vjeshtë, nuk pati formë të mirë. A besoni se në fund ky klub do ta mbyllë me trofe të fituar?

**Islami:** Rezultatet nuk kanë qenë të pritshme në fillim të kampionatit dhe ndikim të madh ka pasur pjesëmarrja në garat e Ligës së Kampionëve dhe Ligës së Evropës. Ne kemi mbetur pak mbrapa me pikë, por jemi brenda objektivave dhe besoj shumë se Feronikeli edhe sivjet do të fitojë trofe, ani pse konkurrenca është mjaft e fortë dhe shumë klube po luftojnë për titull dhe Kupë.

**"Epoka e re":** Ofertat s'ju kanë munguar nga klubet vendore. Pse vendoset që mos të ndërtoni klub apo mendjen e keni te kalimi në ndonjë ligë jashtë Kosovës?

**Islami:** Si në çdo afat kalimtar, edhe tash oferta kam pasur nga klube të ndryshme, por dëshira ime ishte të qëndroj në klub deri në qershor, kur edhe më mbaron kontrata. Jam i fokusuar maksimalisht vetëm në Klubin e Feronikelit dhe për sfidat që na presin në pranverë. Synimi im është ta mbyllim suksesshëm edhe këtë edicion. Në Kosovë i kam fituar të gjithë titujt e mundshëm dhe në qershor do ta shikoj mundësinë të ndërroj ambient, pse jo të kaloj në një kampionat më të fortë.

## Portieri i diagnostifikuar me tumor në lukth do të ndihmohet financiarisht



**PRISHTINË, 14 JANAR** - Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës ka marrë vendim që komuniteti sportiv nëpërmjet kësaj shoqate t'i dalë në ndihmë financiare portierit të Trepçës 89, Arben Beqiri, i cili është diagnostikuar me tumor në lukth. "Më 14 janar 2020, prej orës 12:00, në sallën e

konferencave të FFK-së dhe në prani të medieve, Bordi i Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës mbajti takim informues me kapitenët e ekipeve të futbollit të Superligës së Kosovës, në lidhje me hapat konkretë që do t'i ndërmarrim për t'i dalë në ndihmë shokut

dhe kolegut tonë, Arben Beqirit, portierit në Klubin e Futbollit Trepça '89, i diagnostikuar me tumor në lukth. Në këtë takim u mor vendim që në mënyrë të organizuar ta ndihmojmë financiarisht Arbenin. Ndihma financiare do të bëhet përmes xhirologarisë së Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të

Futbollistëve të Kosovës me numër XK051971002104031174. Me këtë rast, ftojme edhe të gjithë dashamirët e futbollit dhe shoqërinë vendore me vullnet të mirë që t'i bashkohen kësaj iniciative dhe t'i dalim Arbenit krah përgjatë kësaj sfide shëndetësore", thuhet në njoftimin e ShMDFK-së.

## Kokaj, i pasuksesshëm në Lojërat Olimpikë Dimërore

**PRISHTINË, 14 JANAR** - Skitari i Kosovës, Drin Kokaj, i përfundoi garat në Lojërat Olimpikë Dimërore për të Rinj "Lozana 2020". Ashtu sikurse në sllallom të madh, fati nuk ishte me Drinin, i cili u diskualifikua pas

lëshimit të parë, të mbajtur të martën në Qendrën Skitare "Les Diablerets" të Lozanës. Fillimisht Kokaj doli i 50-ti nga 77 garues, por më pas gjyqtarët gjetën një gabim gjatë lëshimit, për çka e diskualifikuan. Sidoqoftë, kjo

është një përvojë e mirë për Kokajn, i cili pati rastin të garojë në ngjarjen më të madhe sportive për të rinj. Në "Lozana 2020" pjesëmarrëse ishte edhe skitarja Era Shala e cila e theu këmbën gjatë përgatitjeve.





## Basiru Mbye përforcon Feronikelin

Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Feronikeli, e ka prezantuar sot futbollistin Basiru Mbye. Sulmuesi nga Gambia do t'i mbrojë ngjyrat e skuadrës nga Drenasi në sezonin pranveror. Mbye ka

lindur më 19 shtator 1999, kurse stili i tij ngjason shumë me të futbollistit të Chelseat, Michy Batshuayi, për nga stili i tij i lojës, mënyra e shënimit dhe fiziku i tij. "Sulmuesi ka

arritur të realizojë plot 28 gola dhe 7 asistime për ekipin 2 të Lokeren, nga Belgjika, para se të kalonte në skuadrën KV Oostende, me të cilën për gjysmë sezoni realizoi 16 gola dhe

bëri 2 asistime. Mbye deri më tani ka përfaqësuar ekipin e të rinjve të Gambisë, gjithashtu ai mori ftesë edhe nga përfaqësuesja A", thuhet në njoftimin e Feronikelit.



# Prishtina synon t'u rikthehet fitoreve ndaj Ponte Prizrenit

Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e 20 e Superligës së Kosovës në basketboll, që do të sjellë ndeshje interesante. Lipjani, që në fundjavë shënoi fitoren e parë ndaj Bashkimit, do të përballet me Golden Eagle Yllin. Lipjanasit kanë një fitore dhe 16 humbje në këtë edicion, derisa skuadra therandase ka 11 fitore dhe gjashtë humbje, duke u renditur në vendin e katërt. Sfidë interesante është ajo ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Ponte Prizrenit. "Bardhekaltrit" janë liderë me 13 fitore dhe katër humbje, kurse prizrenasit renditen në vendin e pestë me 10 fitore dhe shtatë



humbje. Të enjten do të takohen Feronikeli me Rahovecin. Skuadra nga Drenasi ka pesë fitore dhe 12 humbje, kurse Vreshtarët 12 fitore dhe pesë humbje. Ndeshja e fundit e kësaj xhironje do të zhvillohet ndërmjet

dy rivalëve të vjetër, Trepçës dhe Bashkimit. Mitrovicasit ndodhen në vendin e tetë me 20 pikë, kurse prizrenasit kanë grumbulluar 28 pikë, duke u renditur në vendin e katërt. Peja pushon në këtë xhiro.

### SUPERLIGA - JAVA 20

Të mërkurë takohen:

17:00 Lipjani - Golden Eagle Ylli

19:00 Sigal Prishtina - Ponte Prizreni

Të enjten takohen:

17:00 Feronikeli - Rahoveci

19:00 Trepça - Bashkimi

Peja (pushon)

# Lakersat dominojnë në Perëndim

Lakersat vazhdojnë të dominojnë në Konferencën e Perëndimit, duke fituar me rezultat 128-99 ndaj Clevelandit. Një ndeshje me dy pamje, më e mirë për miqtë në pjesën e parë (Kevin Love 21 pikë e 11 rebounde), por në të dytën vjen përmbysja e kalifornianëve. LeBron James realizoi 31 pikë, mbështetur nga Howardi me 21 pikë e 15 rebounde. Pas kohës shtesë fitore ka shënuar New Orleansi, që mundi me rezultat 117-110 Detroitin, ndeshje me emocione në fundin e saj. Për Pelicansin u dallua Okafor me 25 pikë e 14 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Derrick Roses për Pistonsin. Pa problem fitore ka shënuar skuadra e Bostonit, që mposhti me rezultat 113-101 Chicagon, ndeshje ku për Celticsin u dallua Tatum,



autor i 21 pikëve. Në sekondat e fundit triumfon Orlando, që mundi 114-112 Sacramento. Edhe pse Bjelica realizoi 34 pikë për vendësit, ato s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Për Orlandon u dalluan Vuçević (26 pikë e 15 rebounde) e Fournier

me 25 pikë. Rikthehet te fitorja Oklahoma, që mundi 117-104 Minnesotan (Gallinari 30 pikë dhe Alex 20 pikë, 20 rebounde e 10 asistime), ndërsa Portlandi fitoi me rezultat 115-112 ndaj Charlotte (Lillard 30 pikë e McCollum 27 pikë).

## SHKURT

### Sot hapet afati kalimtar dimëror

Sot (e mërkurë) hapet afati kalimtar dimëror në hendbollin e Kosovës. Në afatin kalimtar dimëror, që është prej 15 deri më 22 janar, mund ta ndryshojnë ekipin lojtarët që janë pa kontrata apo ata që kanë fletëlëshimin e klubit konform rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve dhe transferimin e tyre. Ndërsa lojtarët që vijnë nga klube të huaja mund të regjistrohen deri më 28 shkurt.

### Zabërgja rikthehet te KEK-u

Sulmuesi Enis Zabërgja është rikthyer në skuadrën e KEK-ut. Klubi që bënë gara në Ligën e Parë e ka prezantuar sulmuesin me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës. Zabërgja në sezonin vjeshtor ka luajtur për Llapin, kurse në të kaluarën ishte pjesë e Hysit, Hajvalisë, Vushtrisë, Drenicës dhe Trepçës.

### Lacazette, objektiv i Atletico

Atletico Madridi po has në vështirësi për të arritur menjëherë te Edinson Cavani. Trajneri Diego Simeone dëshiron me çdo kusht një sulmues në janar dhe për bomberin uruguaijan nuk ka asnjë sinjal pozitiv nga Paris Saint Germaini ndaj dhe drejtuesit spanjollë kanë nisur ofensivën për Alexandre Lacazette. Ky i fundit nuk është zgjedhja e parë në sulm për trajnerin Mikel Arteta e, gjithashtu, nuk pritet që klubi t'i ofrojë rinovimin ndaj dhe me një ofertë të rëndësishme, sulmuesi francez mund të transferohet drejt "Los Colchoneros".

### Aston Villa prezanton portierin Reina

Aston Villa e ka prezantuar portierin e njohur Pepe Reina, i cili vjen në huazim nga AC Milan. Klubi anglez e ka transferuar portierin spanjoll, pasi portieri Tom Heaton ka pësuar një lëndim që do ta mbajë për një kohë të gjatë jashtë fushës së gjelbër. "Ne kemi arritur të sigurojmë një lojtar si Pepe, i cili ka një përvojë të pasur në Ligën Premierë. Në fillim të verës ne po kërkonim një portier me përvojë dhe sollëm Tom Heaton. Fatkeqësisht, dëmtimi i tij e ka përjashtuar atë për pjesën tjetër të sezonit. Por Pepe u përshtatet kriterëve tona jo vetëm për shkak të përvojës së tij, por edhe për shkak të cilësive të tij drejtuese", thuhet në njoftimin e klubit anglez.

### Tare: Ëndërroj ta drejtoj Shqipërinë

Igli Tare është pa dyshim një nga drejtuesit më të suksesshëm shqiptarë. Emri i tij është lakuar së shumti për sa i përket drejtimit të organit më të lartë të futbollit në vend (FShF-së). Biondi vlonjat ishte i pranishëm së fundmi në turneun e bamirësisë të organizuar në "Air Albania". Veç të tjerash, Tare, në prononcimin pas këtij turneu, foli edhe në lidhje me dëshirën e hershme për ta drejtuar futbollin shqiptar. "Të luash në vendin tënd është diçka e veçantë. Për ato pak minuta u kthyes në kohën tonë si futbollistë. Diçka e bukur. Janë gjëra që kur kthehem i marrim me vete dhe na bëjnë mirë. Duhet të bëhet një traditë që të ketë vazhdimësi. Skuadra e legjendave është diçka që i kujton të gjithë për atë çka kanë kontribuar në kohën që kanë luajtur me Kombëtaren, mbi të gjitha duhet hapur rruga për ngjarje të tilla që ndihmojnë kauza sociale", ka thënë Tare. "E kam thënë gjithmonë, ëndrra ime është ta drejtoja njëherë kombëtaren shqiptare. Është një ëndërr që nuk do të bëhet realitet. Do të ishte diçka e bukur, por për momentin jam më se i lumtur dhe i fokusuar te kjo detyrë që kam", ka shtuar Tare për "Top Channel".

### REZULTAT

Detroit - New Orleans	110-117
Indiana - Philadelphia	101-95
Boston - Chicago	113-101
Minnesota - Oklahoma	104-117
Portland - Charlotte	115-112
Sacramento - Orlando	112-114
Lakers - Cleveland	128-99

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/2828  
Me: 15.11.2019

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

**KONKURS**  
Për plotësimin e vendeve të punës  
Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
